

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5540
E martë, 31 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Reshjet shkaktojnë mbi 7 milionë euro dëme në bujqësi

Shefi i Divizionit për Mbrojtjen e Bimëve në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, njëherësh kryetar i komisionit për vlerësimin e dëmeve në nivel vendi, Adem Arifaj, ka bërë me dije se, sipas vlerësimeve të mbledhura në terren, vlera e dëmeve është mbi shtatë milionë euro ■ PAGE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBYLLUR TË HËNËN SESIONIN PRANVEROR ME DEBATIN DHJETORËSH PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI ■ PAGE 4-5

Nuk ka përafrim për platformën e dialogut me Serbinë

Në Kuvendin e Kosovës partitë opozitare kanë dalë me versione të ndryshme të tekstit të rezolutës sa i përket platformës së dialogut me Serbinë. Propozimet e opozitës për dialogun dallojnë, por emëruet i përbashkët i qëndrimeve opozitare është që dialogun nuk mund ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi. Gjatë debatit për dialogun, kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga deputetët të bashkohen në ekipin gjithëpërfshirës për hartimin e një platforme të përbashkët në këtë proces. Partia më e madhe opozitare, LDK-ja, ka propozuar që fillimisht të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare në mënyrë që të fitohet një legjitimitet i plotë për këtë proces



AKTUALE

**INSTITUCIONI
ADEM DEMAÇI** F.8



Valon MURATI

**PJESËMARRJA E
BOSHNJAKËVE TË
KOSOVËS NË
PROCESIN E
DIALOGUT ËSHTË E
DOMOSDOSHME** F.8



Çerim BAJRAMI

**REKTORI DEMA: VEPRA
E ADEM DEMAÇIT DO TË
JETOJË BREZ PAS BREZI** F.7

EKONOMI

**MBËSHTETJA FINANCIARE, E
NEVOJSHME PËR ZHVILLIMIN
E SEKTORIT PRIVAT** F.9

**HAPET PANAIRI 'GRATË NË
BIZNES', MINISTRI HASANI
PREMTON MBËSHTETJE** F.9

KULTURË

**KUR 'GJARPIJT E GJAKUT'
E LEXONIM TINËZ** F.13

Bedri ZYBERAJ

SPORT

**BATATINA NUK HEQ DORË
NGA LLAPI: KLUBI MBI TË
GJITHË** F.16

**MUSOLLI NDAJ KARABAKUT
THYEN REKORD TE KUKËSI**

F.16

FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA AHMETAJ ■ PAGE 3

Integrimi evropian kërkon konsensus politik



Ish-ministrja e Integrimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, u ka bërë thirrje institucioneve ta shtojnë angazhimin për t'i përfunduar reformat e domosdoshme në mënyrë që shteti i Kosovës të avancojë në procesin e integrimit evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se ky proces duhet

të mbetet prioritet dhe, si i tillë, kërkon konsensus politik. Në këtë kontekst, Ahmetaj ka deklaruar se Kuvendi i Kosovës duhet t'i votojë marrëveshjet për qasje në programet e IPA-s para se të shkojë në pushim vjetor. Ajo ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit të vizave do të përmbillet këtë vit

Sot i jepet lamtumira e fundit Bekim Lumit

Pas një sëmundjeje të rëndë, në moshën 51-vjeçare ka ndërruar jetë regjisori Bekim Lumi. Teatri Kombëtar i Kosovës sot (e martë), duke filluar nga ora 12:00,

do të organizojë homazhe dhe një mbledhje përkujtimore për aktorin dhe regjisorin Bekim Lumi, kurse ceremonia e varrimit do të bëhet në orën 14:00



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Senati amerikan miraton marrëveshjen për ekstradim në mes të Kosovës dhe ShBA-së

UASHINGTON, 30 KORRIK - Senati amerikan në mbledhjen e 26 korrikut ka miratuar marrëveshjen për ekstradim në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Marrëveshja në fjalë ishte nënshkruar më 29 mars të vitit 2016 në mes të ish-presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga dhe ambasadorit amerikan, Greg Delaëie. Si e tillë, kjo marrëveshje shfuqizon atë paraprake të nënshkruar mes

ShBA-së dhe ish-Mbretërisë së Serbisë rreth 100 vjet më parë. "Senati ka pranuar ratifikimin e Marrëveshjes për Ekstradim mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, të nënshkruar në Prishtinë më 29 mars të vitit 2016", thuhet më tutje në procesverbalin e Kongresit Amerikan të datës 26 korrik 2018.

Kujtojmë se atë kohë ish-presidentja Jahjaga kishte cilësuar se mungesa e kësaj marrëveshjeje të ekstradimit kishte qenë pengesë ligjore për përmbylljen e suksesshme të rasteve. Marrëveshja e tillë garanton që personat që kanë kryer krime, dhe që paraqesin rrezik për qytetarët e të dy vendeve, do të ndiqen dhe do të vihen para drejtësisë.



Maas: Zgjerimi i BE-së me vendet e Ballkanit, interes strategjik

Gjatë takimit me homologun shqiptar, Ditmir Bushati, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, tha se zgjerimi i Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor është në interesin strategjik të bllokut



Mass. Ndërsa shefi i diplomacisë shqiptare, Ditmir Bushati, tha se perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor është jetike për përmirësimin e marrëdhënieve në rajon, por do të shërbejë edhe për stabilitetin e

jashtëm dhe të brendshëm, kryesisht për reformat në sektorin ekonomik. "Besojmë se mbështetja e njëzëshme e Gjermanisë për të gjitha vendet në rajon, duke filluar nga Shqipëria, shton vlerat për stabilitetin në rajon, duke pasur

në mendje reformat dhe kryesisht drejtësinë dhe sektorin ekonomik. Kjo do të çojë tek një klimë më e mirë për investitorët dhe marrëdhënie më të mira fqinjësore në rajon", tha Bushati.

Bashkimi Evropian ka filluar procesin e vlerësimit analitik të Maqedonisë dhe Shqipërisë në përgatitje të hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor të vitit të ardhshëm. Një muaj më parë qeveritë e bllokut e shtynë për të paktën një vit vendimin për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë pasi Franca dhe Holanda këmbëngulën për më shumë reforma për goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

TIIRANË, 30 KORRIK - Në Berlin ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas priti të hënën homologun shqiptar Ditmir Bushati për të diskutuar për ambicjet evropiane të shteteve të Ballkanit. Një muaj më parë qeveritë e Bashkimit Evropian e shtynë, të paktën një vit, vendimin për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, tha se zgjerimi i

Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor është në interesin strategjik të bllokut. "Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë të tjerët si Kina dhe Rusia do ta forcojnë influencën e tyre në rajon. Kam bindjen e plotë se popujt e Ballkanit Perëndimor dëshirojnë të jetojnë sikurse në Bashkimin Evropian, jo si popujt në Rusi dhe Kinë. Prandaj është një çështje e rëndësishme për Bashkimin Evropian", tha

Hahn: Shqipëria ka bërë progres me reformat

BRUKSEL, 30 KORRIK - Komisionari evropian i zgjerimit, Johannes Hahn, është i kënaqur me strategjinë e Ballkanit Perëndimor për shkak se ka nxitur një dinamikë të re në rajon. Hahn thekson se Shqipëria ka bërë progres të dukshëm, megjithatë, lutet për realizimin e reformave.



"Shqipëria, e cila ka dalë nga hijja e së shkuarës, i ka lënë vëzhguesit të befapsur këndshëm. Vendi ka bërë përparim të mirë në zbatimin e prioritetëve të reformës, veçanërisht kur është fjala për reformën shumë ambicioze të gjyqësorit. Qeveria ka demonstruar unitet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të orga-

nizuar. Shqipëria, ashtu si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, po punon për zgjidhjen e çështjeve të hapura kufitare dhe në përgjithësi kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore. Për shkak të përparimit të konsiderueshëm të bërë nga të dy vendet, Komisioni Evropian ka rekomanduar që negociatat e pranimit të hapen

me Shqipërinë dhe Maqedoninë", është shprehur komisionari Hahn.

I pyetur për skepticizmin e disa shteteve anëtare për rekomandimin e komisionit për t'i hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, Hahn tha se integrimi në BE i Ballkanit Perëndimor mbi të gjitha është një investim në sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit Evropian. "Zgjerimi i Ballkanit Perëndimor është më i rëndësishëm se kurrë. Ballkani Perëndimor është i rrethuar nga shtetet anëtare të BE-së dhe i përket Evropës gjeografikisht, historikisht dhe në aspektin kulturor", tha Hahn.

Ndahet nga jeta Luan Hajdaraga

TIIRANË, 30 KORRIK - Pas tri ditëve do t'i mbushte plot 70 vjeç, por ka mbyllur sytë pas një sëmundje të rëndë që kaloi. Luan Hajdaraga, një personalitet mjaft i njohur në skenën politike shqiptare, ndërroi jetë të hënën pas disa muajsh që pësoi ishemi cerebrale. Lajmi i hidhur është dhënë nga familjarët, teksa u dërgua në Turqi për mjekim më të specializuar. Në mars të këtij viti ish-ministri i Mbrojtjes ndodhej në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës ku dhe pati krizën e ishemisë. Pas disa kohësh në Spitalin e

Neurologjisë, Qeveria shqiptare akordoi një shumë për kurimin e tij në Turqi, ku dhe ndërroi jetë. Hajdaraga ka qenë eksponent i lartë i PS-së, deputet i kësaj partie, ministër i Mbrojtjes në vitet 1998-2000, në vitin 2003 ka shërbyer edhe zëvendësiministër i Jashtëm.



Kitarović: Kroacia mbështet zgjerimin e NATO-s në rajon

ZAGREB, 30 KORRIK - Presidentja kroate Kolinda Grabar-Kitarović tha se do të mbështesë zgjerimin e NATO-s në rajon, por që secili vend të vendosë vetë nëse do t'i

bashkëngjitet aleancës. "Natyrshet, secili vend duhet të vendosë për vete dhe për askënd nga fqinjët nuk do të flasim me fjalët 'Duhet të shkoni në NATO'. Unë respek-

toj vullnetin e atyre që e kanë hedhur poshtë", tha presidentja kroate.

Kitarović tha se vendet që dëshirojnë anëtarësimin në NATO do ta kenë mbështetjen e

Kroacisë. "Në lidhje me këtë, dua t'u tregoj rusëve: zgjerimi i NATO-s në asnjë mënyrë nuk është i drejtuar kundër Rusisë. Ne nuk e perceptojmë Rusinë si kundërshtar", tha Kitarović.



Flet për "Epokën e re", Mimoza Ahmetaj

Integrimi evropian kërkon konsensus politik



Ish-ministrja e Integrimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, u ka bërë thirrje institucioneve ta shtojnë angazhimin për t'i përfunduar reformat e domosdoshme në mënyrë që shteti i Kosovës të avancojë në procesin e integrimit evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se ky proces duhet të mbetet prioritet dhe, si i tillë, kërkon konsensus politik. Në këtë kontekst, Ahmetaj ka deklaruar se Kuvendi i Kosovës duhet t'i votojë marrëveshjet për qasje në programet e IPA-s para se të shkojë në pushim vjetor. Ajo ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit të vizave do të përmbyllet këtë vit ndërsa, sipas Ahmetajt, Kosovës i mbetet të dëshmojë para shteteve anëtare të BE-së se po e lufton korrupsionin dhe se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e BE-së

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

Prishtinë, 30 korrik - Ish-ministrja e Integrimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, ka thënë të hënën se deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës para se të shkojnë në pushime verore duhet t'i votojnë marrëveshjet për qasje në programet e IPA-s. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka vlerësuar se marrëveshjet e Kosovës për qasje në programet e Bashkimit Evropian si dhe fondet e

IPA-s janë dy çështje të rëndësishme vitale për shtetin e Kosovës. Ahmetaj u ka bërë thirrje institucioneve ta shtojnë angazhimin për t'i përfunduar reformat e domosdoshme në mënyrë që shteti i Kosovës të avancojë në procesin e integrimit evropian. Sipas saj, ky proces duhet të mbetet prioritet i institucioneve vendore dhe, si i tillë, kërkon konsensus politik. "Procesi i integrimit evropian duhet të mbetet prioritet për institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj në vazhdimësi duhet të shtohet puna drejt përbushjes së këtyre kriterëve apo bërjes së reformave të domosdoshme, në mënyrë që shteti ynë të avancojë në këtë agjendë/proces. Integrimi evropian është proces që i takon edhe pozitës edhe opozitës, prandaj për këtë proces është shumë me rëndësi të ketë konsensus politik", është shprehur Ahmetaj. Ajo ka folur edhe për ecurinë e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, duke shprehur optimizëm se ky proces do të përmbyllet këtë vit nga BE-ja. "Për procesin e liberalizimit të vizave jam optimiste që si proces brenda institucioneve të Bashkimit Evropian do të përmbyllet këtë vit", ka deklaruar Ahmetaj. Megjithatë ish-ministrja e Integrimit Evropian ka bërë me dije se shtetit të Kosovës i mbetet të dëshmojë para shteteve anëtare të Bashkimit Evropian se është duke luftuar korrupsionin dhe se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve kosovarë në vendet e Bashkimit Evropian. "Kosova duhet të dëshmojë para shteteve anëtare se është duke punuar në vazhdimësi në luftimin e korrupsionit. Duhet të dëshmojë se i ka përbushur të gjitha kriteret për lëvizje të lirë si dhe duhet të dëshmojë se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e Bashkimit Evropian", është shprehur Ahmetaj.

"Epoka e re": Znj. Ahmetaj, si e komentoni ecurinë e procesit të agjendës evropiane?

Ahmetaj: Procesi i integrimit evropian duhet të mbetet prioritet për

institucionet e Republikës së Kosovës. Në vazhdimësi duhet të shtohet puna drejt përbushjes së këtyre kriterëve apo bërjes së reformave të domosdoshme në mënyrë që shteti ynë të avancojë në këtë agjendë.

"Epoka e re": Në fakt, Kuvendi i Republikës së Kosovës javën e kaluar nuk ka arritur t'i miratojë tri projektligje që janë pjesë e agjendës evropiane. Nëse këto projektligje nuk votohen së shpejti, Kosova humbet mundësinë e aplikimit në fonde me vlerë mbi 80 milionë euro gjatë këtij viti.

Ahmetaj: Marrëveshjet e Kosovës për qasje në programet e Bashkimit Evropian si dhe IPA fondet për këtë vit janë dy çështje të rëndësishme vitale për Republikën e Kosovës. Uroj që Kuvendi t'i votojë këto pika para se të shkojë në pushim vjetor.

"Epoka e re": Kjo qasje e partive politike nga radhët e opozitës a mund ta ngadalësojë procesin integruar?

Ahmetaj: Integrimi evropian është proces që i takon edhe pozitës, edhe opozitës, prandaj për këtë proces është shumë me rëndësi të ketë konsensus politik.

"Epoka e re": Tashmë Komisioni Evropian ka dhënë rekomandimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sa ka gjasa që ky proces të përmbyllet brenda këtij viti?

Ahmetaj: Për procesin e liberalizimit të vizave jam optimiste që si proces brenda institucioneve të Bashkimit Evropian (BE) do të përmbyllet këtë vit.

"Epoka e re": Cila duhet të jetë strategjia e shtetit të Kosovës për t'i bindur vendet anëtare të Bashkimit Evropian që kjo çështje të mos shtyhet për vitin tjetër?

Ahmetaj: Kosova duhet të dëshmojë para shteteve anëtare se është duke punuar në vazhdimësi në luftimin e korrupsionit. Duhet të dëshmojë se i ka përbushur të gjitha kriteret për lëvizje të lirë si dhe duhet të dëshmojë se nuk ka numër të rritur të azilkërkuesve në vendet e Bashkimit Evropian.

Besnik Tahiri thotë se Qeveria do t'u ofrojë përkrahje komunave

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Koordinator i Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, është takuar me kryetarin e Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berishën dhe me kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashin, me të cilët ka diskutuar për projektet e bashkëpunimit ndërkomunal për përmirësimin e shërbimeve në sektorin e ujërave dhe mjedis-

it. Tahiri ka premtuar se Qeveria Haradinaj do t'u qëndrojë pranë të gjitha komunave pa dallim, në mënyrë që të mundësojë një ambient më të favorshëm për investime dhe shërbime më të mira për qytetarët. Besnik Tahiri ka theksuar se këto takime kishin për qëllim diskutimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal, përmirësimin e shërbimeve, në

veçanti në sektorin e ujërave dhe mjedisit. "Qeveria e kryeministrit Haradinaj do t'u qëndrojë pranë të gjitha komunave pa dallim, në mënyrë që të mundësojmë një ambient më të favorshëm për investime dhe shërbime më të mira për qytetarët. Tashmë është dëshmuar shumë mirë përkushtimi i Qeverisë Haradinaj për t'i adresuar sfidat e shumta të qeverisjes lokale", ka thënë Tahiri.



Kuvendi i Kosovës ka mbyllur të hënën sesionin pranveror me debatin dhjetorësh për dialogun Kosovë - Serbi

Nuk ka përafrim për platfor

Në Kuvendin e Kosovës partitë opozitare kanë dalë me versione të ndryshme të tekstit të rezolutës sa i përket platformës së dialogut me Serbinë. Propozimet e opozitës për dialogun dallojnë, por emërues i përbashkët i qëndrimeve opozitare është që dialogun nuk mund ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi. Gjatë debatit për dialogun, kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga deputetët të bashkohen në ekipin gjithëpërfshirës për hartimin e një platforme të përbashkët në këtë proces. Partia më e madhe opozitare, LDK-ja, ka propozuar që fillimisht të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare në mënyrë që të fitohet një legjitimitet i plotë për këtë proces

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë vazhduar të hënën debatin parlamentar lidhur me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohet në Bruksel me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Në Kuvendin e Kosovës partitë opozitare kanë dalë me tri versione të tekstit të rezolutës që pretendojnë të miratojnë në Kuvend. Propozimet e opozitës për dialogun dallojnë, por emërues i përbashkët i qëndrimeve opozitare është që dialogun nuk mund ta udhëheqë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Gjatë debatit për dialogun, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj ka kërkuar nga deputetët të bashkohen në ekipin gjithëpërfshirës për hartimin e një platforme të përbashkët për përfaqësimin e Kosovës në dialog. "Ajo që dua t'ju lus si deputetë është se një temë e vendit tuaj mund të shtrohet në tavolinat e vendim-marrjeve edhe pa kontributin tonë, edhe pa rolin tonë, dhe mund të ecin disa procese në mënyrën si kanë ecur në të kaluarën, pastaj i kemi vajtuar qindra vjet ose kemi provuar t'i sanojmë, por ka qenë vështirë. Për këtë arsye, dua t'ju them merrni në dorë procesin e ardhshëm të dialogut si Kuvend", ka thënë Haradinaj. Kryeministri duke iu përgjigjur akuzave të deputetëve të LDK-së rreth procesit të dialogut u ka thënë deputetëve të kësaj partie

mos të fshihen nëpër "bira të miut". "Qeveria do ta përkrahë me seriozitetin më të madh këtë proces. Po ju lus si Parlament që ta merrni edhe ju përgjegjësinë e juaj, mos u fshiheni nëpër 'bira të miut'", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj duke i ftuar partitë opozitare të bëhen pjesë e dialogut me Serbinë ka thënë se nëse ky proces ngecën atëherë Serbia do të avancojë në procesin e vet integrujes, kurse Kosova do të ngecë. Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate dhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se dialogu final me Serbinë është temë e cila do ta përcjellë Kosovën në muajt në vazhdim. Ai ka thënë se kësaj teme duhet qasur seriozisht.

Limaj në një fjalim të gjatë të mbajtur në Kuvendin e Kosovës ka ftuar deputetët të bëjnë një prerje të dialogut të deritashëm dhe atij që do të fillojë tani. Numri dy i Qeverisë së Kosovës ka thënë se dialogu i deritashëm nuk na prodhuan rezultate dhe se faza finale nuk ka nisur ende. Sipas Limajt, spektri politikë në Kosovë ka kohë që të arrijë një konsensus sa më të gjerë. "Ftesa ime është kemi kohën e mjaftueshme të ulemi si grupe politike për ta bërë platformën të ulemi e të harmonizojmë një qëndrim të përbashkët dhe të gjejmë një formulë e cila përfshin dhe inkorporon një konsensus sa më të gjerë të forcave politike dhe të jemi sa më të përgatitur për këtë pjesë finale. Dialogu i

deritanishëm nuk ka sjellë rezultate, sepse ka qenë jotransparent. Koha është të ulemi seriozisht e të përgatitemi për atë që po na vjen", ka thënë Limaj.

Më tutje, Limaj ka thënë se ka kaluar koha kur një njeri dialogon në emër të Kosovës. "Një marrëveshje e mirë është e dobishme për vendin, një marrëveshje e keqe do të na përcjellë gjithë jetën. Qëndrimi si vëzhgues nuk i takon Kuvendit të Kosovës. Ne mund të qëndrojmë vëzhgues e të themi ishalla po gabojnë, por ai gabim i kushton vendit. E kemi një moment të rëndësishëm kohor që ngadalë ta gjejmë formulën e përfaqësimit dhe formulën e platformës e parimeve dhe të jemi të gatshëm ta përbyllim këtë proces", ka shtuar Limaj. Limaj ka ftuar partitë politike të bëhen bashkë në këtë temë.

Në të njëjtën kohë ai ka kërkuar që deputetët të mos bien pre e propagandave.

Këtëj Kuvendi nuk i takon t'i përflasë thashethemet që fliten jashtë. Le të na shërbejë ky inicim i dialogut që forcat politike të jenë të përfaqësuara në Kuvend dhe ta gjejmë formulën e përfaqësimit. Ky është apeli im", ka përfunduar Limaj.

Ndërsa partia më e madhe opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, ka propozuar që fillimisht të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare në mënyrë që të fitohet një legjitimitet i plotë përfaqësues. LDK-ja kundërshton që dialogu me Serbinë të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi.

Shefi i grupit parlamentar i

Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se LDK-ja mbetet e përkushtuar për një proces dialogues serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese. Ai ka thënë se nisja e një procesi të ri të dialogut me Serbinë pa përgatitje paraprake është e rrezikshme dhe e papërgjegjshme. "Dialogu po tentohet të udhëhiqet nga institucione jolegjitime dhe jashtë mandatit kushtetues të tyre. Ekipet që i tejkalojnë institucionet shtetërore cenojnë përfaqësimin kushtetues të Kosovës në këtë proces dhe përbëjnë kthim prapa. Askush nuk mund ta vendosë fatin e Kosovës në tavolinën e dialogut", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se dialogu duhet të udhëhiqet nga institucionet shtetërore, që kanë kompetenca kushtetuese dhe legjitimitet politik. "Ne jemi të gatshëm të bëhemi pjesë aktive e dialogut, por vetëm pas legjitimitetit qytetar përmes votës së lirë. Ne mbetemi të përkushtuar për një proces dialogues serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese. Ne nuk votojmë asnjë rezolutë e cila mandaton persona që nuk kanë legjitimitet dhe kompetenca kushtetuese për të udhëhequr një proces të tillë", ka thënë Hoti.

Edhe Vjosa Osmani, deputete nga LDK-ja, ka thënë se sot vërtet Kosovës i duhet uniteti, por ajo ka theksuar se uniteti i duhet Kosovës për t'i parandaluar kompromiset që kanë filluar të bëhen për territorin. "Si Kuvend na takon t'u japim fund manovrimeve të Thaçit dhe është koha që për ato tema që njëanshmërisht i ka hapur në Bruksel (presidenti Thaçi), të flasë populli. Meqë sot çështjet që janë në tavolinën e negociatave, nuk prekin çështje teknike meqë ato prekin vetë përkufizimin e shtetit të Kosovës, karakterin e përcaktuar në Deklaratën e Pavarësisë, ku u shpreh vullneti i popullit. Nuk ka sot politikan në Kosovë brenda kësaj sale apo jashtë saj që mund të nënshkruajë marrëveshje për territorin apo çështjet që e vënë në rrezik funksionalitetin e brendshëm të Kosovës si shtet", ka thënë



Osmani.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se dialogu i Brukselit do t'i bëjë vend Serbisë në Bashkimin Evropian, por Kosovës nuk do t'i japë ulësen në OKB. Gjatë fjalës së tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Kurti ka theksuar se para nisjes së fazës finale të dialogut fillimisht do të duhej të bëhej një analizë për marrëveshjet e arritura deri më tani. Kurti ka kërkuar nga grupet parlamentare të bëhen bashkë dhe t'i formulojnë kërkesat që Kosova duhet t'i parashtrijë në dialogun me Serbinë.

Çështja e të pagjeturve dhe dëmet e luftës, sipas Kurtit, duhen hapur në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian. "Dialogu i ri po bëhet jo që Kosova të marrë ulëse në OKB, se ajo është në duar të Rosisë, por që Serbia të marrë ulëse në BE, se ajo është e varur nga shqiptarët. Ky dialog po ndodh për shkak se Serbisë po i nevojitet. Qeveria duhet të sqarojë cili është kuptimi i saktë i shprehjeve normalizim, normalizim i plotë, kompromis i



'mën e dialogut me Serbinë



dhimbshëm e të tjerë", ka thënë Kurti.

Ai ka pohuar se çështja e dialogut me Serbinë nuk është çështje procedurale, është çështje përmbajtjesore dhe nuk duhet të përsëriten ato çfarë

parashohin ligjet dhe Kushtetuta, por duhet të merren qëndrime politike. "Përpara çfarëdo dialogu të ri me Serbinë janë të domosdoshme katër etapa përgatitore: e para, shqyrtim dhe vlerësim i dialogut

2011-2017 dhe rezultateve të tij; e dyta, synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë; e treta, parimet dhe kushtet e dialogut të ri; dhe e katërta, ekipi ynë negociator me strategji dhe udhëheqës", ka thënë Kurti.

Tahiri: LV-ja s'duhet të jetë pjesë e dialogut me Serbinë

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, gjatë fjalës së tij në Kuvendin e Kosovës ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje dhe Albin Kurti nuk duhet të jenë pjesë e dialogut me Serbinë për shkak se e kanë kundërshtuar procesin e deritanishëm të Kosovës. "Unë besoj se Lëvizja Vetëvendosje dhe lideri i saj nuk bën dhe nuk duhet të jenë pjesë e dialogut, sepse e kanë luftuar çdo proces të shtetndërtimit të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye qëndroni në pozicionet e juaja qysh keni qenë për dialogun. Qëndroni në luftimin e rendit kushtetues dhe pikërisht për këtë arsye qëndroni në fjalët e juaja", ka thënë Tahiri. Kreu i MD-së ka thënë se adresa më e rëndësishme politike e ndërkombëtarëve është presidenti Hashim Thaçi. "Mendoj se adresa më e rëndësishme politike e Uashingtonit në këtë vend është presidenti Thaçi. Thaçi në asnjë takim ku është takuar me presidentin Vuçiq nuk ka shkuar krye në vete. Ai ka shkuar me një ftesë", është shprehur Tahiri.

Visar Ymeri nga Partia Socialdemokrate ka thënë se është e rëndësishme që Kuvendi ta miratojë dhe ta shkruajë strategjinë dhe platformën dhe mos t'i lihet në dorë presidentit Hashim Thaçi. Sipas tij, duhet të merret mandati kushdo që negocion me dy të tretat e votave të Kuvendit të Kosovës. "Kjo nënkupton për Kuvendin dhe Republikën e Kosovës, fillim të procesit negociator. Deri tash ka shkuar Thaçi në takime, por ky Kuvend me këtë rezolutë e tregon se ai nuk është legjitim dhe që nënkupton se ky proces negociator nuk pranohet, ose ai që ka ndodhur deri tash. Këto janë ato që janë paraparë në rezolutën e PSD-së", ka thënë Ymeri.

Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, në fjalën e tij në Kuvendin e Kosovës ka bërë

thirrje për bashkim të partive parlamentare në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se interesi i Republikës së Kosovës është jetik për integrimin në BE.

Pajaziti ka theksuar se duhet të bëhet një platformë e përbashkët për procesin e dialogut. Ai ka pohuar se forcat politike nuk duhet të vazhdojnë të jenë të ndara në këtë proces.

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Rasim Selmanaj, ka ftuar opozitën të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi. Ai i ka ftuar partitë opozitare t'i lënë inatet dhe të bëhen pjesë e dialogut. Selmanaj ka theksuar se derisa Serbia në këtë proces udhëhiqet nga presidenti, atëherë çfarë të keqe ka që edhe Kosovën në këtë proces ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi.

Daci për dialogun: Të tejkalohen interesat partiake

PRISHTINE, 30 KORRIK - Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK), akademik Nexhat Daci, ka thënë se kjo akademi është duke e përçjellë me vëmendje procesin e dialogut me Serbinë. Daci ka vlerësuar se është duke munguar qasja e duhur e Kuvendit të Kosovës në këtë proces. "Akademia është e obligueshme të reagojë kur rrezikohet sovraniteti i vendit dhe integriteti territorial. Pikërisht kjo është në fokus në

këtë periudhë dhe s'ka qetësi as në akademi. Opinioni me të drejtë është i shqetësuar. Këtë shqetësim e ngre në temperaturë edhe më tepër sjellja jo e përgjegjshme sa duhet për kohën e të dyja palëve, institucioneve, në veçanti e partive politike", ka thënë Daci në "Info Magazine" të "Klan Kosovës". Ai ka theksuar se ka nevojë të ketë një unitet veprues dhe të tejkalohen interesat e pjesshme qoftë të ndonjë partie apo të një pjese të institucioneve.



Jeton Ujkani, kryesues i Asamblesë Komunale në Mitrovicë, i bashkëngjitet AAK-së

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Jeton Ujkani, kryesues i Asamblesë Komunale në Mitrovicë, është anëtar i më i ri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Jeton Ujkani është një prej autoriteteve më të vlerësuara politike në Mitrovicë dhe kontributi i tij në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë i rëndësishëm. Ujkani ka thënë se i bashkohet

ekipit të Haradinajt dhe AAK-së, i bindur se kjo është në të mirën e vendit dhe të Mitrovicës si qytet tejet i rëndësishëm. AAK-ja e ka vlerësuar punën dhe angazhimin e strukturës udhëheqëse të degës së AAK-së në Mitrovicë si dhe ka bërë me dije se aderimi i Ujkanit do të shërbejë për forcimin e mëtejshëm të AAK-së.



Presidenti Thaçi: Duke nderuar jetën dhe veprën e Demaçit, nderojmë vetveten

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në ditën e parë të punës pas ditëve të zisë, ka bërë homazhe të varri i veprimtarit të shquar, Adem Demaçi. "Ndiej obligim edhe moral, edhe shtetëror, që sot në këtë ditë të parë të punës të nderojmë në mënyrë institu-

cionale dhe shtetërore njeriun e pavarësisë së Kosovës, autoritetin dhe institucionin moral, politik dhe gjithëkombëtar, Adem Demaçin", ka thënë presidenti Thaçi. Kreu i shtetit ka shtuar se duke nderuar jetën e Demaçit ne e nderojmë vetveten. "Duke respektuar dhe nderuar jetën,

veprën dhe angazhimin e tij jetësor për liri të Kosovës dhe për bashkim të shqiptarëve, ne nderojmë vetveten dhe marrim energji për hapat tanë të mëtejshëm", ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka theksuar se shteti i Kosovës dhe kombi shqiptar do ta respektojnë e nderojnë përjetësisht Adem Demaçin.

Në Kosovë ka rënie në rastet e raportuara të trafikimit

EPOKA
ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 30 KORRIK - Në Ditën Botërore kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në Kosovë raportohet një rënie e përgjithshme e rasteve të raportuara të trafikimit. Kjo rënie është falë zbatimit të suksesshëm të iniciativave strategjike kundër trafikimit, ngritjes së vetëdijes dhe ngritjes së kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave të përfshira në luftën kundër trafikimit. Sipas dhënave që ka Ministria e Punëve të Brendshme, në vitin

2017 janë identifikuar 16 viktima të trafikimit dhe janë ngritur 12 kallëzime penale, ndërsa në vitin 2018 janë identifikuar gjashtë viktima të trafikimit dhe janë ngritur pesë kallëzime penale. Sipas hulumtimit të bërë nga BE-ja, gratë dhe fëmijët, veçanërisht ato që vijnë nga zonat rurale dhe më të varfra, identifikohen si më të prekurit nga trafikimi. Sipas hulumtimeve me organizatat lokale, komunat në shumicën e rrezikut janë Mitrovica, Ferizaj dhe Prishtina. Institucionet e Kosovës, me mbështetjen e BE-së, ShBA-së dhe të donatorëve të tjerë

ndërkombëtarë, po trajtojnë me seriozitet trafikimin e qenieve njerëzore. Progres i konsiderueshëm është bërë në Kodin e Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013, duke ashpërsuar dënimet për trafikantët dhe duke penalizuar përdorimin e shërbimeve të viktimave të trafikimit. Për më tepër, Kosova mbetet midis disa vendeve që kanë një ligj për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimeve të trafikimit të qenieve njerëzore, i cili është në fuqi nga viti 2013.



Përrurohet rruga Bare - Gumnishtë



PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, i shoqëruar nga kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe ai i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kanë përruruar rrugën Bare - Gumnishtë, e cila i lidhë Mitrovicën me Vushtrrinë dhe i jep perspektivë zhvillimit të turizmit të Shalës së Bajgorës. Ministri Lekaj, duke falënderuar dy kryetarët, të Komunës së Mitrovicës dhe të Vushtrrisë, ka thënë se ky projekt është një ndër projektet e shumta që Ministria e Infrastrukturës po i zhvillon në shërbim të qytetarëve, zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të turizmit të kësaj ane. Po ashtu, Lekaj ka thënë se ky

projekt ka rëndësi që qytetarët e kësaj ane të mos shpërngulen nga kjo zonë dhe ta zhvillojnë turizmin në vendin e tyre. Kryetari Bahtiri e ka falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen e shumë projekteve të komunave të Kosovës dhe e ka vlerësuar tejet të rëndësishëm këtë rrugë. Edhe kryetari Tahiri ka ndarë shqetësimin e dy komunave lidhur me zgjerimin e rrugës në Vushtri, ndërsa ministri Lekaj i ka siguruar dy kryetarët se tashmë janë kontraktuar tri kompani dhe se së shpejti do të gjendet zgjidhja dhe punimet do të vazhdojnë sipas projektit dhe planit të paraparë.

Rektori Dema: Vepra e Adem Demaçit do të jetojë brez pas brezi

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Me një minutë heshtje në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" ka filluar mbledhja përkujtimore e cila është mbajtur të hënën në nderim të figurës së veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili ka ndërruar jetë javën e kaluar.

Profesoresha Myrvete Dreshaj-Baliu në shenjë të homazhit ka shpalosur para të pranishmëve pjesë nga biografia e Demaçit. "Është vështirë të gesh një moment të rëndësishëm dhe vendimtar të popullit tonë, është vështirë të identifikosh një mal sfidash, sakrificash, luftash e vlerash intelektuale e historike të popullit shqiptar në të cilat të mos ketë reflektuar Bacë Adem Demaçi, në një mënyrë apo në një tjetër, e të mos ketë reflektuar emri, mendimi, vepra dhe biografia jetësore e tij. Me jetën dhe veprën e tij prej eruditit lidhi konceptet politike dhe vetëdijen historike të popullit tonë, e me jetën dhe veprën e tij janë të bashkuara përpjekjet e kombit

tonë dhe perspektiva e domosdoshme e bashkimit si akt i natyrshëm i popujve historikë të Evropës dhe popujve me vetëdije historike, siç janë shqiptarët", ka thënë ajo.

Ndërsa rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, ka thënë se lajmi për vdekjen e Demaçit ka prekur zemrat e shqiptarëve kudo. Ai ka thënë se vepra e Demaçit do të jetojë gjatë brez pas brezi dhe do të kujtohet në mesin e studentëve. Dema ka shtuar se Demaçi i ka trajtuar të gjithë njëjtë, pavarësisht prej përkatësisë kombëtare apo fetare. Ai ka thënë se ndihet krenar që UP-ja ka arritur ta nderojë veprimtarin Demaçi gjatë kohës sa ai ishte gjallë.

Ndërsa djali i Adem Demaçi, Shqiptari, ua ka freskuar kujtesën të pranishmëve, duke kujtuar pjesë nga protestat për këtë universitet. Po ashtu, ai ka përkujtuar çmimet që babai i tij ka marrë nga faktorët ndërkombëtarë.



Reshjet shkaktojnë mbi 7 milionë euro dëme në bujqësi

Shefi i Divizionit për Mbrojtjen e Bimëve, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, njëherësh kryetar i komisionit për vlerësimin e dëmeve në nivel vendi, Adem Arifaj, ka bërë me dije se, sipas vlerësimeve nga terreni, vlera e dëmeve kalon mbi shtatë milionë euro

PRISHTINË, 30 KORRIK - Mbi shtatë milionë euro vlerësohen dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga reshjet e shiut në javët e fundit në disa komuna të Kosovës, kanë bërë me dije zyrtarë të Qeverisë. Në mesin e bujqve të dëmtuar është edhe Bedri Morina nga fshati Drenoc në Komunën e Malishevës, i cili për "Radion Evropa e Lirë" tregon se e gjithë sipërfaqja e të mbjellave në lagjen Morina është dëmtuar. Ai ka thënë se sipërfaqja me mbi 20 hektarë të mbjella me kulturën e grurit është dëmtuar, kurse rreth dy hektarë kanë qenë të mbjella me perime, të cilat, po ashtu, janë dëmtuar.

Morina, megjithatë, thotë se nuk është bërë ndonjë vlerësim i dëmeve. "Patatet, domatet, specat, shalqiri, rrushi dhe pemët, të gjitha janë dëmtuar", ka treguar Morina.

Adem Arifaj, shef i Divizionit për Mbrojtjen e Bimëve, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, njëherësh kryetar i komisionit për vlerësimin e dëmeve në nivel vendi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kulturat më të

dëmtuara gjatë këtij viti janë gruri, pemët, vreshtat dhe perimet.

Sipas vlerësimeve nga terreni, thotë Arifaj, vlera e dëmeve kalon mbi shtatë milionë euro.

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për kompensim të menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara këtë vit nga reshjet e shiut dhe breshrit nëpër komunat e Kosovës. Por, nuk ka përcaktuar shumën e kompensimit pasi, siç është thënë, kjo do të jetë subjekt i analizës dhe mundësive buxhetore. Krahas kësaj, Qeveria ka autorizuar Ministrinë e Financave për krijimin e një fondi të veçantë për vitin 2019 dhe themelimin e Komisionit që do ta krijojë sistemin e sigurimeve të prodhimit të prodhimtarisë bujqësore në Kosovë, për ta stabilizuar tregun e bujqësisë në vend dhe për t'i dhënë përkrahje kësaj fushe.

Por, bujku Bedri Morina tregon se deri më tani nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga niveli komunal apo qendror për mundësinë e kompensimit të dëmeve. "Në komunën e Malishevës më kanë thënë se



nuk kemi mjete për kompensim. Por, megjithatë, zyrtarë të komunës kanë pohuar se nëse ndahen mjete nga Qeveria, mundësitë ekzistojnë. Sidoqoftë, deri më tani ne nuk kemi asnjë informatë për kompensim të dëmeve", ka thënë Morina.

Për ndikimin e reshjeve në zhvillimin e bimëve flet edhe Ymer Rusiniovci, profesor në Fakultetin e Bujqësisë në

Universitetin e Prishtinës. "Reshjet te gruri ndikojnë negativisht sepse ulë peshën e grurit, prolongon procesin e korrjes dhe, për pasojë, mielli që do të realizohet nga ngastrat kultivuese të prodhimit vendor, këtë vit do të ketë cilësi më të ulët. Situatë të ngjashme është edhe te një pjesë e konsiderueshme e perimeve që kanë invazion të madh të reshjeve, përkatësisht të lagështisë",

është shprehur Rusiniovci. Republika e Kosovës ka një sipërfaqe mbi 10 mijë kilometra katrorë, kurse sipas vjetarit statistikor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës për prodhimtari bujqësore në vitin 2016 ka qenë mbi 416 mijë hektarë. Nga kjo sipërfaqe, ara të punueshme kanë qenë mbi 180 mijë hektarë, kurse kopshte rreth 1 000 hektarë.

Automjetet e peregjistruara shkaktuan mbi 4 000 aksidente

Rritja enorme e automjeteve të peregjistruara në vendin tonë është duke i shkaktuar dëme të mëdha buxhetit të shtetit, por edhe kompanive të sigurimeve që operojnë në tregun e Kosovës. Ndërkaq si rezultat i numrit të automjeteve të peregjistruara u shkaktuan mbi 4 000 aksidente, duke lënë të vdekur kështu mbi 100 persona



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Rritja enorme e automjeteve të peregjistruara në vendin tonë është duke i shkaktuar dëme të mëdha buxhetit të shtetit, por edhe kompanive të sigurimeve që operojnë në tregun e Kosovës. Ky ishte konkludimi i përbashkët i pjesëmarrësve në tryezën e organizuar nga "Shoqata e Sigurimeve e

Kosovës", në të cilën morën pjesë zëvendësministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Izmi Zeka, zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, ushtruesja e drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve nga Banka Qendrore e Kosovës, Ramize Ramadani, drejtoresha e Drejtorisë për Regjistrimin e Automjeteve - ARC, Sebahate Muharremi, nga Policia e Kosovës Feriz Lahu, drejtori i

Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Blerim Pushkolli, kryetari i Bordit të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Besar Blakaj, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të

Kosovës, Sami Mazreku, përfaqësues të kompanive të sigurimeve, edhe zyrtarë nga shoqëria civile. "Të dhënat e prezantuara rreth numrit të automjeteve të peregjistruara në raport me vitin paraprak kanë shqetësuar pjesëmarrësit në këtë tryezë. Në raport me vitin paraprak, sivjet janë 109 mijë vetura më pak të regjistruara", është thënë në komunikatën për medie të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.

Sipas kësaj komunikate, po gjatë tryezës u prezantuan edhe të dhëna të sakta rreth humbjeve të mëdha që po i shkaktojnë buxhetit të shtetit, por edhe Industrisë së Sigurimeve mosregjistrimi dhe mospajtimi i automjeteve nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Sipas statistikave

zyrtare, vetëm gjatë vitit 2017 policia ka shqiptuar mbi 12 000 tiketa për automjetet që janë hasur në rrugë pa qenë të regjistruara. Po ashtu, të njëjtat automjete kanë shkaktuar mbi 4 000 aksidente, ku dhe numri i të vdekurve që janë evidentuar nga aksidentet që kanë shkaktuar këto vetura është mbi 100 persona. Gjatë tryezës të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar që në ditët në vijim të gjitha palët që janë të përfshira në këtë proces do ta nënshkruajnë një dokument të përbashkët sipas të cilit të gjitha palët e përfshira në këtë proces do t'i marrin përgjegjësitë e tyre për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete për uljen e numrit të automjeteve të peregjistruara e të pasiguruara në komunikacion rrugor.



Hapet panairi 'Gratë në biznes', ministri Hasani premtion mbështetje

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, gjatë ceremonisë së hapjes të panairit "Gratë në Biznes 2018", ka bërë me dije se ministria të cilën e udhëheq do ta mbështesë këtë panair dhe do të punojë në rritjen e këtyre aktiviteteve për gratë. "Ne si ministri kemi prioritet t'i ndihmojmë gratë në biznes, t'i inkurajojmë që sa më shumë të kemi iniciativa të tilla për ta fuqizuar prodhimin vendor dhe këto artizanale dhe ne jemi të gatshëm si ministri që t'i rrisim këto aktivitete", ka thënë Hasani, duke shtuar se pret që gratë të jenë sa më aktive me projekte të ndryshme e iniciativa ndërmarrëse. "Ne presim që këtë vullnet si Ministri e Tregtisë ta shfrytëzojnë gratë me iniciativa ndërmarrëse që sa më shumë të dorëzojnë projekte, t'i dorëzojnë kërkesat dhe ankesat e tyre që i kanë për t'u zhvilluar", ka thënë Hasani. Ai ka



folur edhe për të drejtat e grave, për të cilat ka thënë se dëshiron të fitohen me meritë dhe punë. "Dëshiroj që gruaja t'i fitojë ato

të drejta me meritë dhe punë dhe jo të kemi kuota kufizuese", ka thënë Hasani. Panairi "Gratë në Biznes 2018"

është i hapur në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë nga 30 korriku deri më 1 gusht. Në panair marrin pjesë rreth 21 biznese

dhe shoqata të grave ndërmarrëse, që gjatë panairit do t'i promovojnë dhe shesin produktet e tyre.

Mbështetja financiare, e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka theksuar se ministria që drejton po synon rritjen e produktivitetit dhe potencialit të kompanive vendore për të arritur një qasje më të lehtë në tregjet rajonale dhe botërore

fushës së inovacionit në Kosovë.

Ndërsa presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahim, ka falënderuar ministrin Beqaj për gatishmërinë e treguar për mbështetjen e fushës së inovacionit dhe ka mirëpritur lansimin e këtij programi, rezultatet e të cilit ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik. Kurse në këtë takim bashkëbisedues, ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit në mes të ministrisë që drejton dhe institucioneve që përfaqësojnë bizneset dhe mbrojnë interesat e tyre. Në këtë kuadër, ministri Beqaj ka bërë thirrje

për bashkëpunim dhe promovim të programeve të ministrisë në shërbim të rritjes së kapaciteteve prodhuese, eksportuese dhe shërbyese të ndërmarrjeve kosovare, duke shfrytëzuar potencialin profesional dhe digjitalizimin e ekonomisë.

Beqaj ka thënë se financimi nga ky program synon kryesisht zhvillimin e sektorit privat. Ai ka theksuar se ministria që drejton po synon rritjen e produktivitetit dhe potencialit të kompanive vendore për të arritur një qasje më të lehtë në tregjet rajonale dhe botërore.

Ministri Beqaj ka njoftuar të pranishmit se ky program synon të financojë tri nivele të bizneseve sipas standardeve të

Kosovës, biznese të mesme, të vogla dhe ato në fushën e inovacionit dhe bizneset startup, të cilat do të financohen nga 10 000 deri në 100 000 euro e që përfshijnë sektorë të ndryshëm dhe jo vetëm nga fusha e inovacionit. "Përmes këtij programi synohet zhvillimi ekonomik në vend nga i cili do të gjenerohen po ashtu edhe vende të reja pune", ka deklaruar ai.

Ministri Beqaj ka bërë me dije se gjatë javës së ardhshme do të publikohet koncepti dokumenti për ligjin e inovacionit i cili përfshin bizneset startup, angel investors, dhe inkubatorët, ndërsa ka përmendur se janë duke punuar në draftimin e strategjisë për ndërmarrësi dhe inovacion.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Në lansimin e programit për mbështetje financiare në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë për bizneset e mesme dhe të vogla nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka zhvilluar të hënën aktivitetin e radhës me

këtë ministri, duke synuar informimin më të hollësishëm rreth këtij programi për bizneset anëtare të saj.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se ky program ka qenë i nevojshëm edhe më përpara si shtysë ndaj sektorit privat në Kosovë. Ai ka përmendur kërkesën e bërë nga komiteti i inovacionit të Odës Amerikane për të pasur një qasje dhe vëmendje më të madhe ndaj




Fillojnë përgatitjet për panairin 'Agrokos'

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Përgatitjet për panairin "Agrokos", i cili do të mbahet nga data 17-19 tetor në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, tashmë kanë filluar. Si panairi më i madh në fushën e agrobiznesit "Agrokos" shquhet për promovimin e prodhuesve vendorë dhe praninë e madhe të kompanive të huaja. Një prani e tillë e kompanive në këtë hapësirë kaq të kërkuar të biznesit nuk ka si të rezultojë ndryshe përveç me rritjen e klientëve të kompanive ekspozuese, marrëveshjeve të reja afariste me partnerë si dhe rritjen e shitjes në përgjithësi jo vetëm në tregun e Kosovës, por edhe më gjerë. Risi tjetër në edicionin e sivjetmë të panairit Agrokos do të jenë edhe dy pavijone të tëra

me prodhimet "Bio" dhe "Hallall". Të gjithë adhuruesit e këtyre ushqimeve, duke vizituar panairin, do të kenë rastin t'i shijojnë ato dhe të informohen më shumë me efektet e tyre pozitive në organizëm. Po ashtu, panairi i sivjetmë i agrobiznesit "Agrokos" për ekspozuesit do të organizojë edhe seminare ku do të diskutohen tema me interes për kompanitë ekspozuese, me qëllim të rritjes së kualitetit të tyre të vazhdueshëm.

Panairi "Agrokos" përgjatë tërë këtyre viteve ka ndikuar në stimulimin e zhvillimit të bujqësisë duke kontribuar pashmangshëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe uljen e papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës.



Pjesëmarrja e boshnjakëve të Kosovës në procesin e dialogut është e domosdoshme

- Boshnjakët kundër ndarjes së Kosovës dhe shkëmbimit territorial me Serbinë



Cerim BAJRAMI

Pothuaj nga të gjitha palët paralajmërohet përsheptimi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë me qëllim të nënshkrimit të mundshëm të një "marrëveshjeje ligjërishme e detyrueshme" midis dy vendeve. Në anën tjetër, askush nuk ka iluzione se këto marrëveshje që do të pasojnë në muajt e ardhshëm do të jenë të lehta. Në lidhje me këtë, presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, flet edhe për "kompromise të dhimbshme", ndërsa presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, rregullisht thekson dhe vëmendjen përqendron në fjalën "kompromis" për të cilën nuk ka thënë ende publikisht se çfarë nënkupton kompromisi për Serbinë. Andaj, ditët e fundit bashkëpunëtorët e tij të ngushtë nuk hezitojnë të flasin se kjo do të thotë ndarje e Kosovës që përafërsisht nënkupton se katër komunat në veriun e saj do t'i përkasin Serbisë.

Po ashtu, flitet që ka pasur edhe propozime joformale për një shkëmbim të këtij territori (përndryshe ekonomikisht jashtëzakonisht i rëndësishëm për Kosovën) me luginën e Preshevës, pjesa e të cilit do t'i takonte Kosovës.

Tek faktorët politikë të Kosovës,

përpos kundërshtimit për ndarje, ende nuk ka konsensus midis pozitës dhe opozitës rreth "vijave të kuqe", respektivisht rreth formimit të një ekipi të përbashkët për negociatat përfundimtare me Serbinë, ndonëse për një unitet po bëhen shumë thirrje edhe nga ana e presidentit të shtetit Thaçi, kryeministrit Haradinaj dhe tani edhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili e ka pasur në agjendë çështjen e arritjes së një konsensusi kombëtar për dialogun me Serbinë, ku në takimin më 23 korrik kanë marrë pjesë vetëm përfaqësues të koalicionit qeverisës dhe përfaqësues të komuniteteve joserbe nga Grupi 6+. Komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë ShBA-në, e mbështet dialogun dhe kërkon një zgjidhje ligjërishme të detyrueshme. Bisedimet drejt normalizimit po mbahen në Bruksel nën patronazhin e BE-së dhe ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini...

Boshnjakët e Kosovës, si komunitet i dytë joshumicë nga numri, menjëherë pas serbëve, dhe si një popull që ka qenë kurdoherë i pranishëm në komunat e veriut të Kosovës si për nga numri i tyre ashtu edhe nga lokalitetet e veçanta dhe pronës të patundshme, ndonëse të dobësuar, politikisht gjithsesi të ndarë, dhe pa ndihmë nga ana e të tjerëve, nuk duhet të përjashtohet përsëri në këtë fazë përfundimtare të dialogut, në të kundërtën askush nuk mund të garantojë se të drejtat e tyre do të jenë të garantuara në mënyrë

adekuate me marrëveshjen eventuale, veçanërisht në kuadër të komunave në Kosovën e veriore. Këtu duhet theksuar se nuk ka dyshim se në interes të boshnjakëve nuk është ndarja e Kosovës apo shkëmbimi terriroresh, sepse në të dyja rastet qytetarët e Kosovës do ta humbasin numrin e popullit dhe territorin e tyre, përkatësisht vendbanimet boshnjake në veri të Kosovës.

Pa mospjesëmarrjen e boshnjakëve në bisedime humbet edhe ajo pak çfarë mund të fitohet. Të përkujtojmë vetëm disa marrëveshje të nënshkruara vitet e fundit në Bruksel, për shembull atë për gjykata dhe prokurori. Pikërisht këto marrëveshje, siç kam theksuar publikisht në disa raste në Kuvendin e Kosovës në rolin e ish-deputetit, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë dyetnike sepse saktësisht precizojnë vetëm numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë dhe serbë, prandaj (jo vetëm sipas meje) drejtpërdrejt janë shkelur dispozitat e Kushtetutës së Kosovës dhe Planin e Ahtisarit për Kosovën. E ngjashme dhe e njëjtë ishte situata edhe e marrëveshjeve të tjera që kanë prekur "integrimin e pakicës serbe në veri", respektivisht punësimin në Policinë e Kosovës, në administratë etj., ku janë punësuar vetëm anëtarët e komunitetit serb.

Përveç shkeljes së të drejtave në punësim, boshnjakët në komuna në veri të Kosovës nuk kanë të drejtën elementare njerëzore dhe kombëtare - fëmijët e tyre nuk kanë të drejtën e shkollimit në

gjuhën amtare, në gjuhën boshnjake, nga ana tjetër bashkathetarët e tyre që jetojnë në komunat e tjera të Kosovës këtë të drejtë e kanë tanimë 19 vjet rresht etj. Pse për këtë është heshtur, ose nuk është folur fare, është tregim tjetër dhe i gjatë.

Veç këtyre, duhet të thuhet se boshnjakët në veri nuk kanë as lirinë e të shprehurit për ta bërë këtë të çartë publikisht ose të kërkojnë këtë të drejtë në vazhdimësi. Sigurisht, gjithmonë ka përjashtime, si rasti i ish-kuvendarit në Kuvendin e Mitrovicës së Veriut, Nexhat Ugljanin, i cili, fatkeqësisht, nuk është rizgjedhur për shkak të rrethanave dhe gabimeve mes boshnjakëve në procesin e zgjedhjeve. Kështu aktualisht boshnjakët në atë komunë e as në Komunën e Leposaviqit nuk kanë më kuvendarë të tyre në kuvendet lokale.

Dhe duke folur për lirinë dhe sigurinë në atë pjesë të Kosovës, le të kujtojmë se nuk ka lëvizur asgjë dhe nuk është hedhur asnjë dritë lidhur me vrasjen e aktivistit politik boshnjak Shefko Salković i cili është vrarë në fshatin Rvatske në dhjetor të vitit 2010. Të ndjerin ish-presidentja e Kosovës në vitin 2012 e kishte dekoruar me medaljen e heroit kombëtar. Por, për fat të keq, gjithë këtë kohë e veja e tij dhe vajza e vogël kanë ngelur në (pa) mëshirën e askujt dhe nuk kanë asnjë ndihmë si nga niveli lokal, po ashtu edhe nga shteti i Kosovës.

Një fat i ngjashëm e ndan edhe Edin Islamović, shoku i mbijetuar i Shefkos që me atë rast si bashkëud-

htar u plagos rëndë, në prit në atentatin kundër tyre. Edini bashkë me shoqen dhe fëmijët endet nëpër Mitrovicën e Jugut, meqë pas disa muajsh e kanë larguar nga puna në administratën e komunës. Atë e kanë larguar nga puna para katër-pesë vjetësh, menjëherë pasi pushtetin lokal e ka marrë ekipi i kryetarit Bahtiri, me arsyetim se Islamović ka qenë në grupin e atyre aktivistëve përkrahës të PDK-së që janë punësuar në mënyrë jo të rregullt.

Duke marrë parasysh të gjitha këto dhe faktin se boshnjakët në "Mahallën e Boshnjakëve" në Mitrovicë dhe në fshatin e madh Rvatska në Leposaviq, ende mbijetojnë, pavarësisht prej sfidave të mëdha dhe dëbimit masiv, përfaqësuesit e boshnjakëve, Qeveria, presidenti, kreu i Kuvendit, i Republikës së Kosovës, si dhe komuniteti ndërkombëtar, menjëherë duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur të legjitimohen interesat e ligjshme të këtij komuniteti të vjetër në atë pjesë të Kosovës, që edhe ato të jenë subjekt i të gjitha marrëveshjeve dhe (nën)akteve ligjore. Ndërsa përfshirja e tanishme për dialog të përfaqësuesve legjitimë të boshnjakëve të Kosovës në ekipin negocues dhe në trupat punuese të paralajmëruara do të ishte hapi i parë i këtyre pritjeve legale e demokratike.

(Autori është zëvendësimistër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, dhe ish-deputet në Kuvendin e Kosovës nga komuniteti boshnjak)

Vihet gurthemeli i Qendrës së Edukimit Joformal për rini në Pjetërshan të Gjakovës

GJAKOVË, 30 KORRIK (ER) - Në Pjetërshan të Gjakovës të hënën është vënë gurthemeli i Qendrës së Edukimit Joformal për Rini, si një qendër rekreative për fëmijë dhe të rinj, arritur sipas marrëveshjes në muajin maj, në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe OJQ "George Williams Youth Association in Kosovo" (GWY). Në ceremoninë e organizuar, ndër pjesëmarrësit e shumtë, mori pjesë edhe ministri Kujtim Gashi.

Në ndërtimin e kësaj qendre parashihet që MKRS-ja të investojë 150 mijë euro. Me këtë rast, ministri Gashi u shpreh se ndërtimi i qendrës të cilës iu

vendos gurthemeli është një projekt kapital i cili do të ofrojë kushte shumë të mira për zhvillimin e aktiviteteve të rinjve dhe edukimin e mëtejshëm të tyre. "Ky gurthemel ka qenë një ëndërr e gjithë neve gjeneratave të kaluara. Kosova duhet të ketë një qendër nacionale të edukimit joformal, por asnjëherë nuk kemi arritur këtë derisa janë bashkuar shumë forca, palë, njerëz e, mbi të gjitha, persona të vullnetit të mirë", ka thënë Gashi.

Kryetari i Komunës së Gjakovës, Adrian Gjini, ka deklaruar se komuna dhe Kosova në përgjithësi ka përfituar nga ky projekt. Ai ka theksuar se ky

vend është atraktiv edhe në sezonin dimëror. Ai shpreson se kampi do të ekzistojë për ndërtimin e solidaritetit në mes të njerëzve. "Komuna ka marrë përsipër ta ndërtojë rrugën deri këtu, rruga do të ndërtohet pas mbarimit të ndërtimit të objektit dhe është buxhetuar për vitin tjetër, ku shpresoj se vitin e ardhshëm do të jenë të gjitha gati", ka thënë Gjini.

Presidenti i Bordit të Drejtorëve të organizatës YMCA, Petrit Bejdoni, ka falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët të cilët ndihmuan për këtë ditë të implementimit të këtij projekti për qendrën e të rinjve, që komuna e Gjakovës tani do ta ketë.



Institucioni Adem Demaçi

Baci ka qenë njeri i dashuruar me lirinë. Kësaj dashurie i ka qëndruar besnik deri në fund. Ka qenë i paepur, i pandalshëm, i papërkulur; dhe këtë dashuri ka arritur ta bëjë ngjitëse. Ka bërë që mijëra shqiptarë, të shkelur e të nëpërkëmbur, të frymëzuar nga dashuria e tij për lirinë, të dashurohen edhe ata me lirinë



Valon MURATI

1. Çdo komb ka nevojë të ketë figura të tilla që tejkalojnë qenien fizike dhe që shndërrohen në institucione të cilat janë pika referente për të. Ato institucione zhvishen nga përditshmëria, nga gabimet e cenet dhe mbesin pika orientuese për kombin e njerëzimin. Nuk ka dyshim se ata janë dhe mbesin njerëzorë. Duke qenë njerëzorë, ata arrijnë të shndërrohen në institucione. Ashtu siç ndodh edhe me dëshmorët. E veçanta e këtyre njerëzve është se ata me jetën, angazhimin, veprën e mendimin e vet, arrijnë që të frymëzojnë të tjerët, të orientojnë dhe të mobilizojnë. Jo të gjithë i kanë njohur qëndrimet e Mandelës apo të Gandit. Por ata me veprën e tyre kanë ngritur mijëra njerëz në funksion të arritjes së lirisë. Edhe ne shqiptarët, duhet të jemi krenarë që i kemi dhënë botës një figurë të tillë. Ne duhet të krenohemi që i dhamë botës Adem Demaçin.

2. Adem Demaçi ishte një institucion i kombit shqiptar. Shkrimtar, gazetar, aktivist, i burgosur politik, politikan,

humanist, kryengritës e rebel dhe, mbi të gjitha, figurë qendrore e lëvizjes për liri të shqiptarëve në trojet e veta nën Jugosllavi. Lirisht mund të thuhet se ka qenë njeri i dashuruar me lirinë. Kësaj dashurie i ka qëndruar besnik deri në fund. Ka qenë i paepur, i pandalshëm, i papërkulur dhe këtë dashuri ka arritur ta bëjë ngjitëse. Ka bërë që mijëra shqiptarë, të shkelur e të nëpërkëmbur, të frymëzuar nga dashuria e tij për lirinë, të dashurohen edhe ata me lirinë. E dashuria është edhe ëndërr. Është edhe shpresë. Edhe ideal. Por ajo di të bëhet edhe realitet. Ai besonte në dashurinë ndaj lirisë si realitet, edhe pse na vinte në formën e shpresës, ëndrës dhe idealit. Kishte kohë kur dukej se kjo "sëmundje" nuk përhapej sa kishte ai dëshirë, por ky ishte sekret i saj. Ajo përhapej fshehtë, mbahej brenda familjeve tona, e sidomos rinia ishte ajo që u bë pasuese e kësaj dashurie. Dhe kur u mbrujt, mirë e ngadalë, pas demonstratave të vitit 1981, pas burgjeve masive, pas rezistencës paqësore e sidomos pas kryengritjes së UÇK-së, dashuria në lirinë u bë jo vetëm publike, por shtylla kurizore e lëvizjes sonë çlirimtare. Madhështia e frymëzuesit, e institucionit Adem Demaçi, ishte se ai këtë dashuri nuk e kishte të kufizuar vetëm për shqiptarët. Ai besonte në universalitetin e lirisë, dhe ishte i gatshëm të sakrifikonte nga autoriteti i tij,

për të luftuar edhe për lirinë e serbëve, romëve, boshnjakëve e të gjithë atyre që jetojnë në Kosovë. Ai besonte në lirinë e njerëzimit.

3. Ai ishte jonkonvencional. E thoshte atë që mendonte. Mendimin e përgjigjet i kishte në majë gjuhe. Herë na pëlqente, herë nuk na pëlqente. Herë ia qëllonte, herë nuk ia qëllonte. Por një njeriu me mendime për çdo gjë, i lejohej edhe gabimi në vlerësim. Në vlerësimet taktike edhe ka mundur të gabojë, në strategji asnjëherë. I paepur në rrugën e lirisë, të çlirimit dhe të bashkimit. Në momentet vendimtare, çdoherë në vendin dhe në rrugën e duhur. E kjo kulmoi jo vetëm me përkrahjen, por edhe me inkuadrimin në radhët e UÇK-së. Dhe në këtë angazhim të rëndësishëm jetësor përfundoi logjikshëm. Sepse asnjëherë nuk kishte gabuar në një vlerësim: se liria është e domosdoshme. Se për të duhet sakrifikuar, sepse përndryshe do të mbesin nën robëri e nën Serbi. Se për atdheun, për kombin e për njerëzimin të gjithë duhet të jemi ushtarë. Ama ushtarë jo me një shërbim, por tërë jetën. Ai ishte ushtar i përjetshëm i lirisë, i atdheut, i kombit e i njerëzimit. Një luftëtar model i lirisë.

4. Respekti dhe dashuria për të është popullor. Sigurisht ka nga ata që nuk e kanë dashur, apo edhe që e kanë urreyer. Sidomos për shkak se ishte i sinqertë dhe e thoshte atë që mendonte në çdo vend. Por ata janë pak. Më shumë mund të jenë ata që nuk janë pajtuar me të, por e kanë respektuar. Sidoqoftë, për Adem Demaçin kishte një dashuri të madhe në atë që mund të quhet krahu i sakrificës i lëvizjes sonë çlirimtare. Duke qenë vetë ndër ata që janë frymëzuar nga vepra e Bacit, e kam mbajtur pishtar lirie edhe atëherë kur nuk jam pajtuar me të. Duke qenë pjesë e

lëvizjes ilegale çlirimtare (LKÇK e më vonë UÇK) mund të konstatoj pa hezitim, se ai ka qenë një figurë qendrore morale, për mobilizim, organizim, rezistencë e luftë të armatosur. Jam dëshmitar i kësaj dashurie brenda UÇK-së. Në radhët e ushtarëve dhe komandantëve të UÇK-së, ai ka qenë figura e padiskutueshme e një lideri shpirtëror e politik, pa ndonjë pozitë të fuqishme udhëheqëse. Jam dëshmitar sesi të gjithë ushtarët, shumica e komandantëve më të njohur, që sot i duam e nuk i duam, që në opinion mund të kenë zë për të keq e për të mirë, që ishin apo shiteshin të fortë, para tij përulshin. Ishin në gjendje të ulnir kokat, të bëheshin si fëmijët para babait, dhe simbolikisht po them, ishin në gjendje të duronin edhe ndonjë shuplakë të këtij "njeriu të vogël", që e konsideronin si figurë të padiskutueshme e të pakontestueshme për ta. Pra, brenda UÇK-së, përveç njerit, asnjëherë nuk ka pasur autoritete të tilla. Ai ishte Baci. Ai ishte Adem Demaçi.

5. Intermexo. Në maj të vitit 1999 ishim shumë keq me furnizime në ushqim në Zonën Operative të Llapit, në pjesën e Malësisë së Gollakut ku vepronte Brigada 153 "Hyzi Talla". Së bashku me djemtë e gueriljes së Prishtinës "BIA", zëvendës komandantin Bahri Gashi, vendosëm të futeshim në Prishtinë, në disa nga bazat e tyre për të krijuar disa kanale furnizimi. Njëkohësisht, vendosëm edhe në koordinim me komandant Remin, Fatmir Humollin, Agim Kuletën etj., të bëjmë përpjekje për të nxjerrë nga Prishtina, Bacin Adem. Me vete mora një tjetër bashkëpunëtor të LKÇK-së dhe të UÇK-së, Driton Hysenin. Pasi u futëm në Prishtinë, Dritoni, i cili mund të lëvizte edhe publikisht nëpër Prishtinë,

gjithnjë duke rrezikuar shumë, shkoi aty ku jetonte Baci. Çdo përpjekje e tij për ta nxjerrë Bacin ishte e kotë. Të falat e mija, të Remit e të Fatmirinuk bënë punë. "Driton, Bacit, unë kam vendosur të vdes" - i kishte thënë ai Dritonit. Çfarë të flitet më me njeriun, i cili ka vendosur të vdesë, që është kufiri i fundit me të cilin mund ta frikësosh dikë. Ai kishte vendosur të vdesë, sepse në panteonin e kombit tashmë kishte hyrë të jetonte përjetësisht.

6. Si do ta trajtojë historia? Çka do të thonë gjeneratat e ardhshme për të? Po ato vija politike që ishin kundërshtarë të tij? Në horizontin e kohës ai do të shtrihet sigurisht si një prej figurave qendrore të padiskutueshme në historinë e luftës për liri të popullit shqiptar. Do të trajtohet si shtylla orientuese, si fanar. Një njeri i pandalshëm për të mirën e përgjithshme. Në të ardhmen kundërshtimet dhe konfliktet e tij politike do të shihen si pjesë e një debati normal politik. Do të mbetet vepra e tij madhore. Do të mbetet dashuria e tij për lirinë. Fakti se ia mbajti gjallë tërë një popull shpresën për liri dhe e "infektoi" atë me dashurinë për lirinë. Do të mbahet mend se ishte i aftë të falte, të pajtohej edhe me kundërshtarët politikë, edhe me ata që ishin në anën e atyre që e burgosën. Gjithnjë në funksion të unitetit kombëtar dhe pajtimit të gjeneratave të ardhshme. Do të mbahet mend se ishte i gatshëm të pajtohej edhe me popujt e tjerë, edhe me serbët. Prapë në funksion të lirisë dhe jetës në paqe e liri të gjeneratave të ardhshme. Adem Demaçi do të zërë vend edhe në historinë e njerëzimit, si luftëtar për ta zgjeruar lirinë njerëzore duke e çliruar popullin e vet dhe popullin që e mbante në robëri popullin e tij.

Mbahet kampi i 'Super-Vullnetarëve' në Gërmi

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Me përkrahje të Komunitetit të Prishtinës dhe organizatës WWF Adria është mbajtur kampi i "Super-Vullnetarëve" me 40 të rinj nga Kosova, të cilët për një javë kanë qëndruar në Qendrën Rekreative të Gërmisë, duke punuar për realizimin e projekteve vullnetare përmes të cilëve do të përmirësojnë shkollat publike në Kosovë. Të rinjtë pjesëmarrës në kamp, përmes aktiviteteve socializuese dhe edukative zhvilluan shkathtësitë e tyre të punës me dru, komunikimit dhe bashkëpunimit. Ata kontribuan në komunitet duke ndërtuar orendi të ndryshme për përmirësimin e dy klasave të

shkollave fillore "Sezai Surroi" në fshatin Bellobrad-Drageash dhe "Liria" në fshatin Stroc të Vushtrrisë. Kampi i "Super-Vullnetarëve" u organizua nga Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA me qëllim që t'i zhvillojë tek pjesëmarrësit kompetencat e parapara me Kornizën e re Kurrikulare të Kosovës.

Ky kamp u financua nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA), ndërsa u menaxhua nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



Kryeministri grek Tsipras viziton zonën e prekur nga zjarri

ATHINË, 30 KORRIK - Kryeministri i Greqisë, Alexis Tsipras, vizitoi zonën e prekur nga zjarret e javës së kaluar që lanë dhjetëra të vdekur në një vendpushim bregdetar në ver-

ilindje të Athinës. Tsipras vizitoi Rafinën, duke përfshirë pjesën e djegur me tendë, Matin dhe bisedoi me qytetarët, si dhe me zjarrfikës, ushtarë dhe vullnetarët që

kanë shkuar të ndihmojnë. Të hënën e kaluar flakët e ndihmuara nga erërat e forta prekën zonën bregdetare në verilindje të Athinës duke u shndërruar në zjarret më

vdekjeprurëse të Greqisë në disa dekada. Shumica e viktimeve humbën jetën nga zjarri, ndërsa disa të tjerë u mbytën teksa notonin për t'u shpëtuar flakëve.



'New York Times' i reagon Trumpit: Mos i quani gazetarët armiq!

Publikuesi i gazetës "New York Times", AG Sulzberger, tha se i ka thënë Trumpit se fraza "lajm i rremë" është e pavërtetë dhe e dëmshme, por ka shtuar se është "shumë më i shqetësuar për etiketimin që ua bënë presidenti gazetarëve si armiq të popullit"

WASHINGTON, 30 KORRIK - Publikuesi i gazetës "New York Times" i bëri thirrje presidentit amerikan Donald Trump ta ndalojë etiketimin e gazetarëve si "armiq të popullit", duke thënë se kjo mund të çojë në dhunë kundër medieve. AG Sulzberger i bëri këto komente pas takimit me Trumpin në Shtëpinë e Bardhë dhe pas deklarimeve të presidentit rreth këtij takimi.

Në postimin e parë në "Twitter", Trumpi tha se ka qenë një takim "shumë i mirë", por më vonë ai i akuzoi mediet për vënien e jetës së njerëzve në rrezik, përmes raportimit të tyre. "Kaluan shumë kohë duke folur për sasinë e madhe të lajmeve të rreme në media dhe për atë se si fraza 'lajme të rreme' është shndërruar në frazën 'armik i popullit'", tha Trumpi.

Gazeta "New York Times" pastaj

lëshoi deklaratën e saj, duke thënë se ka vendosur t'u përgjigjet komenteve të presidentit.

Sulzberger tha se ka pranuar takimin me Trumpin për të ngritur shqetësime në lidhje me retorikën e thellë kundër shtypit të presidentit. Ai tha se i ka thënë Trumpit se fraza "lajm i rremë" është e "pavërtetë dhe e dëmshme", por shtoi se është "shumë më i shqetësuar për etiketimin që ua bënë presidenti gazetarëve si armiq të popullit". "Paralajmërova se kjo gjuhë nxitëse kontribuon në rritje të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe se do të çojë në dhunë", tha Sulzberger.

Ai tha se ia ka bërë me dije presidentit se një gjë e tillë tashmë ndodh në vende të tjera, ku retorika e tij shfrytëzohet nga disa regjime për t'i shtypur gazetarët. "E paralajmërova se po vë jetë në



rrezik, po dëmton idealet demokratike të vendit tonë dhe se po shkatërron një nga eksportet më të mëdha të vendit tonë: angazhimin për fjalën e lirë dhe shtypin e lirë", tha Sulzberger. Ai shtoi se nuk kërkon nga Trumpi që të mos e kritikojë gazetën e tij nëse

nuk është i kënaqur me mbulimin, por tha se i bën thirrje atij "t'i rishqyrtojë sulmet më të gjera ndaj gazetarëve".

Pasi deklarata e Sulzbergerit u bë publike, Trumpi u përgjigj në "Twitter", duke thënë se mediet që raportojnë mbi "diskutimet e

brendshme" të Qeverisë, "e vënë vërtet në rrezik jetën e shumëkujt, jo vetëm të gazetarëve".

Trumpi tha se media "po çmendet nga Sindroma e Zënkës me Trumpin" dhe e akuzoi atë për publikimin e "artikujve të këqij edhe për arritjet pozitive".

Rusia, Irani, Turqia diskutojnë për konfliktin në Siri



MOSKË, 30 KORRIK - Përfaqësues të Rusisë, Iranit dhe Turqisë nisën bisedimet dyditëshe për Sirinë, në qytetin rus, Soçi. Ministria e Jashtme ruse tha se disa tema janë në tryezën e diskutimeve, përfshirë formimin e një komiteti kushtetues të Sirisë, zonat e sigurta brenda Sirisë dhe çështjet humanitare.

Edhe pse mbështesin anë të ndryshme në konfliktin sirian, Turqia, Rusia dhe Irani e kanë nisur procesin e negociatave vitin e kaluar në kryeqytetin e

Kazakistanit, Astana, duke diskutuar kryesisht për çështje si armëpushimi dhe zonat e sigurta.

Një proces tjetër i negociatave, i udhëhequr nga Kombet e Bashkuara dhe i përqendruar në çështjet politike, është zhvilluar në Gjenevë.

Delegacioni rus në Soçi po udhëhiqet nga i dërguari i posaçëm i Kremlinit për Sirinë, Aleksandr Lavrentyev.

Zëvendësministri i Jashtëm iranian, Hossein Ansari, dhe zëvendësministri i Jashtëm turk,

Sedat Onal, i përfaqësojnë vendet e tyre. Në bisedime marrin pjesë edhe i dërguari i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Sirinë, Staffan de Mistura, dhe përfaqësues të Qeverisë së presidentit sirian, Bashar al-Assad. Turqia tha të dielën se planifikon të mbajë një samit me Francën, Gjermaninë dhe Rusinë, në fillim të shtatorit, për të diskutuar për konfliktin në Siri dhe çështje të tjera rajonale. Rusia, Franca apo Gjermania nuk e konfirmuan ende këtë takim.

Mali i Zi jep nënshtetësi për investime

PODGORICË, 30 KORRIK - Qeveria e Malit të Zi ka vendosur ta ringjallë projektin e nënshtetësisë ekonomike, i cili, sipas reaksioneve, do të jetë i dobishëm për shtetin, por edhe mund të sjellë dëme serioze. Në vendimin më të ri të Qeverisë, prej 1 tetorit do të jetë e mundur të merret

nënshtetësia e Malit të Zi në bazë të investimeve të para në projektet zhvillimore. "Programi i shtetësisë ekonomike do të jetë në dispozicion për një maksimum prej 2,000 aplikuesve më të referuar nga vendet jo anëtare të BE-së gjatë një periudhe të kufizuar prej tre vjetësh", tha

qeveria në një deklaratë. Ambasadori i BE-së në Malin e Zi, Aivo Orav, tha se Qeveria e Malit të Zi duhet ta shqyrtojë me kujdes çështjen e nënshtetësisë ekonomike në mënyrë që ajo të mos bëhet pengesë në rrugën e vendit drejt integritimeve evropiane.

Në dispozicion do të jenë dy variante të nënshtetësisë ekonomike. E para, nënkupton investimin prej 250 mijë eurosh në projekte zhvillimore në rajonet e pazhvilluara të Malit të Zi dhe i dyti investime nën të njëjtat kushte, por në lartësi prej 450 000 eurosh.



Kur 'Gjarpijt e gjakut' e lexonim tinëz

Bedri ZYBERAJ

Njeriu që javën e kaluar ndërpreu frymëmarrjen dhe të cilit i pushoi së rrahuri zemra, Adem Demaçi, ka qenë i veçantë. Jo vetëm për kohën e gjatë të qëndrimit në burg (sa keq më vjen kur e cilësojnë si Mandela i Evropës apo Kosovës, sepse Mandela kishte mbajtur 27 vjet burg, ndërkaq Demaçi një vit më shumë, dhe për ta vlerësuar të parin nuk duhet të emërtohet me emrin e të dytit. Përkundrazi, i dyti duhet të vlerësohet me emrin e të parit. Në këtë rast, Mandela që ka vuajtur 27 vjet burg ishte Demaçi i Afrikës sepse ky i dyti ka vuajtur 28), por edhe për shumë aspekte të tjera të jetës dhe veprimtarisë së tij.

Ka shumë prej ne të gjallëve që me këtë emër na lidh diçka e veçantë.

Unë për veten time mund të them se emrin e tij e kam dëgjuar kur kam qenë nxënës i klasës së tretë të shkollës fillore. Më vonë, vija duke u mbushur me informacion dhe sa më shumë që kalonin vitet, isha kureshtar të mësoja më shumë për të dhe nga ai. Atë botë, kuptohet që kureshtjen tonë e provokonte më së shumti romani i tij "Gjarpijt e gjakut". Pavarësisht prej shumë përpjekjeve, atë nuk ia dola ta gjeja deri në nëntor të vitit 1986. Në atë muaj, më saktësisht më 9 nëntor, jam martuar (me një dasmë tradicionale ku kisha dhe bijtë e Sefës, shumica tanimë të ndërjerë e Beqa dëshmor i kombit) dhe, përveç farefisit, kisha ftuar

edhe disa profesorë të mi të fakultetit (prof. Qosjen, prof. Latif Berishën dhe prof. Fadil Sylejmanin, paçka se nuk erdhën!) dhe disa shokë.

Një prej tyre ishte edhe Jakup Bajraktari.

Në pasditen e të shtunës, që ishte nata e dasmës (pra në pasditen e 8 nëntorit të vitit 1986), Jakupi kishte ardhur për dasmën time. Në një qese plasmasi kishte futur një dhuratë dhe kur vjen afër odës ku ishin burrat, të pranishmit që ishin gjendur aty në atë rast, i urojnë mirëseardhje dhe e ftojnë të hyjë brenda në odë. Në një rast të tillë, kuptohet se ai duhej t'i jepte dhuratën. Njëri, me besimin që Jakupi do t'ia jepte dhuratën për ta dërguar në shtëpinë time, i afrohet dhe, si për ta ndihmuar, i bën me shenjë që t'ia jepte dhuratën. Ky kuptohet se nuk e dinte se çfarë kishte brenda. Mirëpo, meqë jetonim në një kohë për të cilën dinë se çfarë ishte vetëm ata që e kanë përjetuar, Jakupi refuzon t'ia japë dhuratën dhe i pyet se ku është Bedriu.

Ata i tregojnë se në atë çast nuk isha aty, por do të vija pak më vonë. Atëherë ky u thotë se do të më pres derisa të vija unë e nuk do të hynte në odën e dasmorëve. Qesen nuk e kishte lëshuar nga dora! Pas një kohe unë arrij dhe përshëndetem me të. Ata që ishin të pranishëm aty më qortuan se pse u vonova, ngaqë Jakupi kishte pritur gjatë e kishte ngelur pa hyrë në odë që sa kohë, duke pritur te dera.

Edhe mua m'u duk kjo gjë interesante.



E kujtoj se jam përpjekur ta tejkaloj atë çast disi me humor dhe pasi u përshëndeta me të, ai më mori lehtësisht për krahu e të dy u larguam paksa nga të tjerët që ishin aty.

Më tha:

- Shiko! Këtu, - dhe më tregoi qesen - ke dhuratën prej meje. Ama nuk pata guxim t'ia jepja askujt tjetër përpos teje dhe po të them të mos e hapësh për ta shikuar në prani të të tjerëve. Hape vetëm kur je vetëm. Tani shko dhe siguroje diku që të mos e shikojë çdokush sepse në dasmë ka çmos!

Unë ngela disi i habitur se nuk e merrja me mend se çfarë mund të kishte aty brenda dhe u bëra vërtet kureshtar.

Mora dhuratën, Jakupi hyri brenda dhe unë u nisa për në shtëpinë time ku ishte pjesa

tjetër e dasmorëve. Pasi u largova ca dhe duke pasur parasysh këshillën e Jakupit që dhuratën mos ta shikonin të tjerët, kur pashë se isha larg syrit të të tjerëve, vendosa të shikoj se çfarë kishte aty. Kureshtja më torturonte nga brenda dhe ma mbyti durimin që duhej ta kisha derisa nuk shkoja në shtëpinë time.

E hapa!

Ç'të shoh?

Ishte libri i Adem Demaçit "Gjarpijt e gjakut" i botuar në Zvicër dhe portreti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut i gravuar në bakër.

Kjo ishte arsyeja që Jakupi nuk e kishte parë të udhës që dhuratën t'i linte në dorë dikujt tjetër ngaqë ata nuk i njihnte. Për librin e Demaçit atëbotë, vetëm po të ta gjenin, dënoheshe së paku një dy vjet burg. Dënoheshe, sepse

ata e dinin se çfarë përfaqësonte dhe si funksiononte ky emër. Dhe nuk është se nuk ia kanë qëlluar!

Unë, me atë rast, u ndjeva jashtëzakonisht mirë dhe mu bë qejfi që më në fund më ra në dorë libri i Adem Demaçit, i njeriut, emri i të cilit është bërë shpresa e shpëtimit tonë. Kjo mund të tingëllojë paksa mitizuese por, në fakt, nuk duhet marrë kështu.

Kur them se emri i tij ishte bërë shpresa e shpëtimit tonë, kam parasysh faktin e idealit që përfaqësonte ai emër dhe jo të fuqisë fizike, sepse Adem Demaçi ishte njeri me trup të vogël, por me zemër të madhe ideale të shenjta për kombin tonë. E tillë do të mbetet shëmbëlltyra dhe koha e tij pas ditës së nesërme!

Sot i jepet lamtumira e fundit Bekim Lumit

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Pas një sëmundjeje të rëndë, në moshën 51-vjeçare, ka ndërruar jetë regjisori nga Kosova, Bekim Lumi. Regjisori Lumi ishte profesor në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ndërkohë që në skenat e teatrove ka ngritur një numër shfaqjesh të suksesshme. Në qershor të këtij viti regjisori Lumi vuri në skenë shfaqjen e tij të fundit, "Arturo Ui", të autorit Bertolt Brecht.

Teatri Kombëtar i Kosovës sot (e martë), duke filluar nga ora 12:00, do të organizojë homazhe dhe një mbledhje përkujtimore për aktorin dhe regjisorin Bekim Lumi.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Teatrit Kombëtar, Milot Mustafa, ka bërë me dije se Këshilli Organizativ ka vendosur që në orën 14:00 të jetë ceremonia e varrimit.

Ngushëllime familjes Lumi i ka shprehur presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Në një shkrim në rrjetin social "Facebook", presidenti Thaçi e ka cilësuar të dhimbshëm lajmin mbi vdekjen e regjisorit Lumi. "Si artist e si

regjisor, Bekim Lumi kontribuoi shumë për artin, teatrin, kulturën dhe për edukimin e artistëve të rinj. Ngushëllime familjes Lumi dhe të gjithë artistëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij!", ka shkruar presidenti Thaçi.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka cilësuar të pikëlluar lajmin "për kalimin në amshim" të regjisorit Bekim Lumi. "Ikja e hershme e Lumit ka lënë një zbrazëti të madhe në familje, shoqëri dhe sidomos në artin e regjisë. Ai nuk rreshti për tri dekada me radhë t'i jepte vulën e tij origjinale artit dramatik të Kosovës. Ngushëllime të singerta familjes Lumi, të gjithë atyre artistëve që punuan me të si dhe miqve të shumtë", ka shkruar kryeministri Haradinaj në rrjetin social "Facebook".

Edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka thënë se e ka marrë me pikëllim të madh lajmin për vdekjen e parakohshme të regjisorit dhe profesorit Bekimi Lumi. "Pas një lufte më shumë se dyvjeçare, me një sëmundje të



rëndë, bota e artit shqiptar dhe jo vetëm, e ka humbur një prej pedagogëve dhe regjisorëve më të talentuar. Regjisori Bekim Lumi, i cili me shfaqjet e tij të shumta e që karakterizoheshin me aspektin minimalist dhe eksperimental, e ka përfaqësuar vendin tonë në shumë festivale teatrore brenda dhe jashtë Kosovës, duke e prezantuar suksesshëm artin

teatrore ku u nderua edhe me çmime të shumta", ka thënë Gashi.

Ai ka shtuar se skenës teatrore të vendit tonë do t'i mungojë zelli dhe kreativiteti i Bekimit, ndërsa ka pohuar se për kulturën shqiptare ndarja e parakohshme e tij nga jeta nga beteja me sëmundjen është një humbje e madhe. "Angazhimi dhe suksesi i

tij për familjen duhet të jenë krenari dhe jo dhimbje kurse për ne, shokët, kolegët dhe artdashësit, duhet të jetë nxitje dhe frymëzim. Ngushëllime familjes, miqve dhe dashamirëve të Bekim Lumit", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook". Regjisori Lumi tash e dy vjet ka qenë duke u përballur me sëmundjen e kancerit.

E rrallë

Santorini, aty ky gomarët përdoren për taksi

Në ishullin e bukur të Santorinit në Greqi gomarët përdoren për taksi për turistët që frekuentojnë këtë vend piktoresk, por kjo shpeshherë është kthyer edhe në abuzim, për keqtrajtimin e këtyre kafshëve, pasi pronarët e tyre duhet të transportojnë



njerëz me peshë të madhe katër apo pesë herë në ditë.

FOTO E DITES



Forcat ajrore spanjolle "Patrulla Aguila" kryejnë një aktivitet demonstrimi në ajër. /AFP/

E jashtëzakonshme

Zbulohet specie e re: Gjysmë balenë, gjysmë delfin

Gjysmë balenë, gjysmë delfin. Një specie e tillë është zbuluar në shkencëtarët në brigjet e ishullit Hauai. Gjytari, sipas shkencëtarëve, ka lindur nga një nënë e llojit balena kokë-shalqi dhe me baba



një delfin, që i përkasin që të dy një specieje të rrallë që jetojnë në Oqeanin Paqësor.

BARSOLETA E DITËS



Gjakovari në kafe

- Kamerier, çfarë po pinë ajo biondja e mirë, se desha t'i ofroj diçka?
- "Coca Cola" në gotë.
- Dërgoja nja dy copa akull prej meje.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

"FUTURE WORLD" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Keni shumë çështje për të zgjidhur gjatë ditës së sotme. Pjesa e parë e ditës do të ketë aktivitete të shumta. Mbrëmja do të jetë më e qetë.



DEMI

Idetë që keni duhet t'i vini në veprim dhe t'i zhvilloni. Problemi i vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.



BINJAKËT

Dikush po mundohet t'ju vë shkopinj nën rrota sot. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm, do të dini si të dilni nga kjo situatë.



GAFORRJA

Mund t'i lini gjërat të rrjedhin vetë. E rëndësishme është që në një moment të caktuar ju do të keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.



LUANI

Hap pas hapi do të arrini të mbliidni dhe ju sukseset tuaja. Shikoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.



VIRGJËRËSHA

Në varësi të humorit do ta keni edhe sjelljen sot, por personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.



PESHORJA

Jeni vëzhgues të mençur dhe sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.



AKREPI

Sot nuk duhet të ekzagjeroni në kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkon mund të kenë kushtet për t'u realizuar.



SHIGJETARI

Mos kërkon aventura sot sepse nuk do të mund ta përballoni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.



BRICJAPI

Indiferenca në shumë raste është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon çaste të dhimbshme që mund të na lëndojnë.



UJORI

Konsideroni atë që ju thotë instikti juaj i pagabueshëm sot. Mund të jetë momenti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.



PESHQIT

Sot do ta keni mundësinë t'i analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitete.

Zbulohet arsyeja e mbidozës në të cilën kaloi Demi Lovato



Prishja e marrëdhënieve me trajnerin Mike Bayer, njeriu që i qëndroi afër dhe e mësoi të mos përdorte droga, ka qenë shkaku i mbidozës që këngëtarja ka rënë së fundmi, shkruan "Sun". Arsyeja e konflikteve mes Bayer dhe Lovato


ishite një debat i fundit që ata patën, ku Mike i kishte thënë asaj gjëra që këngëtarja nuk dëshironte t'i dëgjojë, pasi kohët e fundit vetëm justifikojë për sjelljet e gabuara të saj dhe nuk i tregonte atij për gjërat që bënte.

Dua Lipa, e çmendur pas të dashurit të saj



Pop artistja shqiptare Dua Lipa është parë shumë e dashuruar pas të dashurit të saj Isak Carev. Ajo ka postuar fotografi ku shihet mbi

të dashurin e saj. Në postimin që ia ka dedikuar atij, Lipa shkruan se ndihet shumë krenare dhe e inspiruar nga Isak.



Rita Ora mban koncert në shi, fejon një çift në skenë

Stina e verës për Rita Orën është çdoherë e stërbushur me koncerte. Ajo gjithë kohën poston foto dhe video të performancave të veta në koncerte madhështore nëpër botë. Të dielën në mbrëmje

Rita ka postuar disa video ku as shiu nuk e ka ndaluar atë që ta mbajë koncertin e paralajmëruar në Perth të Australisë. Madje gjatë koncertit Rita i kishte dhënë hapësirë një çifti që të fejohen në skenë.

Unikkatili më 4 gusht në Durrës

Reperi shqiptar Viktor Paloka, i njohur si Unikkatili, përmes një video në rrjetin social "Facebook" u është drejtuar fansave, duke i ftuar ata në koncertin e tij që do të mbahet më 4 gusht në stadiumin "Niko Dovana" në Durrës. "Në Durrës për

me i bo krejt shqipet bashkë. Paqe", shprehet Unikkatili, i cili në video shihet së bashku me Klepton, i cili është, po ashtu, pjesëtar i labelit TBA. Kjo është hera e parë që reperi performon në Shqipëri, ndërsa biletat do të jenë nga 15 euro deri në 200 euro për VIP.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

KRYLYA SOVETOV - CSKA MOSCOW

2

HALMSTADS - DEGERFORS

1

FIGUEIRENSE - CRB

1

Batatina nuk heq dorë nga Llapi: Klubi mbi të gjithë

Adhuresit e futbollit në Podujevë duhet të qëndrojnë të qetë, pasi Tahir Batatina nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga skuadra e Llapit. "Nuk ka asgjë të vërtetë në lidhje me largimin tim nga Llapi. Të gjithë e dinë se ky klub që pesë vjet qëndron mbi supet e mia. Nuk lejoj që për gjëra të vogla të humbet munda im pesëvjeçar, sepse Llapi është mbi të gjithë", ka thënë Tahir Batatina



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 KORRIK - Skuadra e Llapit në vitet e fundit identifikohet shumë me trajnerin Tahir Batatina, i cili është donatori kryesor në klub. Ai ka qenë trajner për një kohë të gjatë, kurse tash e mban postin e drejtorit sportiv. Pas zërave se ai do ta braktisë skuadrën nga stadiumi "Zahir Pajaziti", Batatina të hënën për "Epokën e re" e ka mohuar një gjë të tillë. "Nuk ka asgjë të vërtetë në lidhje me largimin tim nga Llapi. Të gjithë e dinë se ky klub që pesë vjet qëndron mbi supet e mia. Nuk lejoj që për gjëra të vogla të humbet munda im pesëvjeçar, sepse Llapi është mbi të gjithë", ka thënë Batatina.

Ditët e fundit është përfolur shumë se Llapi ka shkëputur marrëveshje me trajnerin Bylbyl Sokoli, i cili besohet të ketë pasur "përplasje" me drejtuesit e klubit rreth ideve se si duhet të funksionojë skuadra e Llapit në të ardhmen. Batatina ka hedhur poshtë mundësinë që Llapin ta drejtojë dikush tjetër në edicionin e ri futbollistik 2018/2019, por ka rikujtuar se janë rezultatet ato që e mbajnë trajnerin në bankën e një skuadre. "Sokoli e ka kontratën njëvjeçare me skuadrën e Llapit, por dihet se trajnerin e mbajnë vetëm rezultatet dhe asgjë tjetër në bankën e një skuadre", ka deklaruar ai. Tahir Batatina e udhëhoqi me sukses Llapin në Ligën e Parë duke e rikthyer pas një kohe të

gjatë në Superligë, kurse në edicionin 2016/2017 e kualifikoi këtë skuadër deri në finale të Kupës, ku më pas pësoi humbje nga Besa e Pejës në penallti. Në kampionatin e fundit arriti që gjatë sezonit vjeshtor të dominojë plotësisht në futbollin e Kosovës duke u shpallur kampion për këtë sezon, por në pranverë nuk arriti ta mbajë skuadrën në formën më të lartë dhe e humbi garën për titull. Pas përfundimit të kampionatit, Batatina me drejtuesit e tjerë të Llapit vendosen të bëjnë reforma dhe ishte pikërisht ky trajner që e liroi pozitën e shefit të shtabit teknik për ta marrë postin e drejtorit sportiv me synime që në edicionin e ri të fitojë trofe dhe ta sigurojë pjesëmarrjen në garat evropiane.

SHKURT

Kosova U18, kampione e Evropës për Divizionin C

Kombëtarja e Kosovës U18 në basketboll ka shkruar historinë, duke fituar trofeun e parë. Djelmohat e Kosovës u shpallën kampione të Evropës për Divizionin C. Kosova mposhti në finale Qipron me rezultat 73:64, në një ndeshje të dominuar gjatë tërë kohës nga lojtarët tanë. Lojtari më i mirë (MVP) i kampionatit u shpall Rron Ukaj i Kosovës. Kampionati Evropian U18 u mbajt në Prishtinë. Pas këtij suksesi, Kosova tani e tutje do të garojë në Divizionin B.

Ferizaj prezanton Bërbatovcin, Karabegun dhe Jasharin

KF Ferizaj, pasi angazhoi Afrim Tovërlanin në postin e trajnerit për edicionin 2018/2019, ka vazhduar përfortifikimet. Kjo skuadër ka transferuar Florim Berbatovcin, Granit Jasharin dhe Fuad Karabegun. "Bërbatovci, që është paraqitur në disa skuadra të Superligës, është një nga sulmuesit më të mirë në futbollin vendor. Gjithashtu, edhe Karabegu (KF Gjilan) dhe Granit Jashari (Prishtinë) janë mesfushorë me cilësi të larta dhe pritet të na ndihmojnë në objektivat e klubit", thuhet në njoftimin e KF Ferizaj.

Tucheli, trajneri më i paguar në Francë

Trajneri i Paris Saint-Germain, Thomas Tuchel, është trajneri më i paguar në kampionatin francez të futbollit. E përditshmja franceze "L'Equipe" ka raportuar se Tucheli ka një rrogë vjetore prej 5.04 milionë eurosh te PSG-ja.

Federeri e ka një ëndërr të madhe për Wimbledonin

Grand slam i Wimbledonit mbetet i preferuari për tenistin zviceran Roger Federer, turne të cilin e ka fituar tetë herë në karrierën e tij. Këtë vit, numri dy në botë ishte sërish favorit, por u eliminua në çerekfinale. Duke folur nga Dubai, ku edhe po përgatitet për pjesën e dytë të sezonit, tenisti zviceran rrëfeu një sekret në lidhje me turneun londinez. "Sa herë që ndodhem në këtë turne lexoj gazetata dhe rreshtat e fundit, ku janë intervistat e fansave që vijnë aty për t'i parë ndeshjet. I admiroj njerëzit që kalojnë natën jashtë, në tenda, duke pritur radhën për të siguruar një biletë. Dhe kur i pyesin se për kë bëjnë tifo, ata thonë emrin tim. Kjo më mallëngjen pa masë", ka thënë Federeri. "Gjithnjë kam ëndërruar të kaloj më shumë kohë me këta njerëz, të flas me ta, të dëgjoj historitë e tyre, të cilat mund të kenë lidhje edhe me mua. Nuk e di se si do të reagoja në këtë rast. Mendoj se këtë gjë mund ta realizoj vitin tjetër, ndoshta duke i takuar fansat ditën e parë të turneut, që janë më të shumtë", ka deklaruar Federeri.

Musolli ndaj Karabakut thyen rekord te Kukësi

KUKËS, 30 KORRIK - Ndeshja kthyesë ndaj Karabakut në Azerbajxhan është speciale për mesfushorin nga Kosova, Besar Musolli. Ky i fundit do ta barazojë rekordin e 21 përfaqësimeve në arenën

ndërkombëtare të ish-kapitenit Hallaci, ndërsa do të vendosë edhe rekordin e 216 ndeshjeve në të gjitha kompeticionet me ekipin. "21 ndeshje në Evropë, aq sa edhe Hallaci, janë mirë dhe aq

më shumë ndihem mirë sepse do të kaloj një legjendë të kësaj skuadre si Rrahmani. Shpresoj se këtë ndeshje ta mbyllim edhe me kalimin e turit. 216 ndeshje në total do të thonë shumë. Kemi

fituar dhe kemi humbur. Gjithsesi, nëse bëj një bilanc, mund të them se kemi më tepër kujtime të bukura dhe suksese", ka thënë Musolli për "Supersport".



Zogaj në Ligën e Kampionëve për ndeshjen Rosenborg - Celtic

PRISHTINË, 30 KORRIK - Gjyqtari i njohur nga Kosova, Bekim Zogaj, do të ketë edhe një përvojë të re në garën elitë të klubeve evropiane në futboll, Ligën e Kampionëve. Zogaj është caktuar të jetë asistenti i parë në ndeshjen e rrethit të

dytë kualifikues në mes të Rosenborgut (Norvegji) dhe Celticit (Skoci). Takimi do të zhvillohet më 1 gusht në "Lekerdal Stadium" të Trondheim në Norvegji. Ndeshjen e parë e kishte fituar Celtic 3-1, ndërsa kjo nuk

është hera e parë që Zogajt i besohet ndarja e drejtësisë në këtë nivel garash. Bekim Zogaj jeton dhe ushtron aktivitetin në Zvicër, e disa herë ka qenë në Kosovë për ta ndarë përvojën e tij me kolegët nga Kosova. Ai do të

jetë në Kosovë nga 4-11 gushti në seminarin e radhës për gjyqtarët e futbollit. Gjyqtari nga Kosova, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, drejtoi me sukses sfidën Barcelona - Manchester City për të rinj.



De Laurentiis thumbon Juven: CR7, blerje e mirë komerciale

NAPOLI, 30 KORRIK - Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, është shndërruar në një "showman" të vërtetë gjatë këtyre ditëve të afatit kalimtar. Bosi napolitan është rikthyer të flasë sërish për transferimin e Cristiano Ronaldos te Juventus, duke e cilësuar më tepër si një lëvizje komerciale sesa sportive. "Ronaldo te Juventus ishte një gjetje e bukur nga ana komerciale. Tashmë bardhezinjtë kanë përmirësuar imazhin e tyre dhe do të mund të afrojnë më shumë sponsorë, por të shpenzosh një shifër të atillë për një 34-vjeçar duket e paimagjinueshme. Në fund do të shohim, nëse përfitimet e Joves do të jenë më të mëdha në aspektin komercial, apo edhe atë sportiv", ka thënë De Laurentiis, i cili ka folur edhe një herë për propozimin që iu bë Napolit për t'i marrë shërbimet e Ronaldos para se të dilte në



skënë Juventus, ndërsa tregoi edhe arsyet pse nuk u finalizua ky operacion. "Kur Mendezi ma ofroi Ronaldon dhe më tregoi për kostot, i thashë se do ta blija, nëse binim dakord që 250 mil-

ionë eurot e para që do të vinin nga marketingu, do t'i përfitonte Napoli dhe të tjerat më pas, futbollisti. Më pas erdhi Juventus, që vendosi të rrezikojë...", ka shtuar De Laurentiis.

LeBron: Gabova që djalit ia vendosa emrin tim

LOS ANGELES, 30 KORRIK - Ylli i basketbollit, LeBron James, thotë se i vetmi peng që i ka mbetur në jetë është që i ka vendosur të birit emrin e tij, LeBron Jr, për shkak të presionit që ky emër do të ushtrojë tek ai për të arritur të njëjtin nivel suksesi. "Jam penduar që djalit tim 14-vjeçar i kam vendosur emrin tim", ka thënë James në një intervistë në episodin e parë në një serial që do të transmetohet në ShBA të quajtur "The Shop". Emisioni i plotë është llogaritur të transmetohet në gusht. 33-vjeçari sapo është transferuar në Los Angeles ku do të jetë pjesë e Lakersit sezonin e ri të NBA-së, pasi nënshkroi një marrëveshje katërvjeçare prej së cilës do të fitojë 154 milionë dollarë. Në klipin e shkurtër të shpërndarë në rrjete sociale, komediani amerikan Jon Stewart e pyet yllin e basketbollit për familjen e tij dhe se si ai ia del t'i sigurojë fëmijët e tij, sidomos LeBron Jr,



të njohur si Bronny, që të menaxhojnë pritshmëritë për të arritur po aq sukses sa i ati. "Ata luajnë të njëjtin sport në të cilin t'i luan më mirë se kushdo tjetër në botë... si arrin t'i qetësosh e t'i bindësh që nuk duhet patjetër të realizojnë atë që ke bërë ti?", e

pyet Stewart. "Kur unë isha fëmijë nuk kisha baba, kështu që gjithmonë kam dashur që me fëmijët e mi të bëja gjithçka që babai im nuk bëri dot. U takon atyre ta ndjekin rrugën e tyre, kurdo që kjo të ndodhë", ka deklaruar Jamesi.

SHKURT

Legjenda e Unitedit: Shaqirit i duhet përkrahë Ronaldinho

Legjenda e Manchester Unitedit, Gary Neville, e kishte kritikuar Xherdan Shaqirin pas transferimit në Liverpool, por shqiptari në debutimin e tij shënoi gol ndaj Manchester Unitedit dhe faqja e tij në "Twitter" është "bombarduar" nga tifozët. Neville nuk ka qëndruar duarkryq dhe ka shkruar: "Shpresoj të mos më dërgoni mesazhe sa herë ta shikoni atë të qëndrojnë në qendër të mesfushës, çdo herë kur skuadra juaj të jetë duke u sulmuar. Oh, dhe ai ka nevojë për Ronaldinhon që të luajë me të".

Giroudi nuk dëshiron të largohet nga Chelsea

Sulmuesi Olivier Giroud nuk dëshiron të largohet nga skuadra e Chelsea. "Daily Mail" raporton se edhe përkundër faktit se francezin e dëshiron skuadra e Marseillet, ai nuk preferon të largohet nga Premierë Liga, madje është i vendosur të luftojë për vendin e titullarit. Në anën tjetër, Chelsea është shumë e interesuar për transferimin e sulmuesit të Juventusit, Gonzalo Higuain.

Essieni pensionohet nga kombëtarja

Ish-mesfushori i Chelseat, Michael Essien, është pensionuar nga kombëtarja e Ganës. Ai 12 vjet ka luajtur për këtë kombëtare, kurse ishte paraqitur edhe në Kupën e Botës "Brazil 2014". Essieni ka qenë pjesë e Lyonit, Real Madridit dhe Milanit, kurse aktualisht është lojtar i lirë, pasi është ndarë nga skuadra e Persib Bandung.

Juve synon rikthimin e Pogbas

Skuadra e Juventusit është e interesuar për ta rikthyer Paul Pogban në Torino. Lajmi është bërë me dije nga "Daily Mirror". Kampionia e Italisë, pas transferimit të Cristiano Ronaldos, po dëshiron të godasë edhe një herë fuqishëm në këtë afat kalimtar. Sipas mediumit britanik, Juve për ta sjellë Pogban në Itali është gati t'i shesë disa futbollistë cilësorë.

Bailly bën pjesë në planet e Mourinhos

Pavarësisht se Jose Mourinho po e kërkon transferimin e një mbrojtësi në Manchester United, Eric Bailly nuk do të largohet nga "Old Trafford" në këtë afat kalimtar, njofton "Manchester Evening News". Unitedi e ka siguruar mbrojtësin e Bregut të Fildishtë se e ardhmja e tij është në këtë klub, por ata dëshirojnë transferimin e Harry Maguire nga Leicester City dhe Toby Alderweireld nga Tottenham Hotspur.

Neymari: Dua të ndryshoj

Neymari ka kaluar çaste të vështira pas eliminimit të Brazilit nga Belgjika në Botëror. Ai u vendos në qendër të kritikave për rrëzimet e tij në fushë dhe se impenjimi i tij nuk ishte maksimal. "Shenjat e takave në pulpë, gjunjët në shtyllën kurizore, ju mendoni se unë e teproj. E vërtetë, e ekzagjeroj ndonjëherë, por unë vuaj në fushë", ka thënë Neymari, i cili betohet se do të jetë një person tjetër pas kritikave dhe se ka kaluar çaste të vështira. "Mu desh kohë e gjatë t'i pranoja kritikën tuaj. Jam parë në pasqyrë dhe jam transformuar si njeri. Unë u rrëzova, por vetëm ai që rrëzohet, ringrihet. Më ndihmoni të qëndroj në këmbë, sepse kur unë jam në këmbë gjithë Brazili është me mua", ka deklaruar sulmuesi i PSG-së.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinički Centar Kosova University
 Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, dhe nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12, neni 13 pika 1 dhe neni 15 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, dhe shkresa elektronike e datës 24.07.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Nr	Kërkohe:	Klinika/Shërbimi	Janë kërkuar:
1.	Mjekë Specialistë të Peditër në Intensivë	Pediatri	2
2.	Mjekë Specialistë të Anesteziologjisë	Anesteziologji -M.I.	1
3.	Mjekë Specialistë të Kardiologjisë	Sh.K.i Emergjencës	2
4.	Mjekë Specialistë të Oftalmologjisë	Oftalmologjisë	2
5.	Mjekë Specialistë të ORL-së	Otorinolaringologjisë	2
6.	Mjek Specialist të Gjinekologjisë	KOGJ.	1
7.	Psikolog Klinik	QKUK	3

I. Koficienti i pagës: (8.4) Për Mjekës Specialistë
 Koficienti i pagës: (7.2) Për Psikolog Klinik.
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit të Klinikës Përkatesë
Nr. i Referencës: QKUK - 29/2018-07/13

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditorë të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohe lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësisimit profesional dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe në ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe

- Certifikata e lindjes, fotokopje.

II. Përshkrimi i punës për Psikolog Klinik

- Të përdor metoda të ndryshme dhe bashkëkohore, me qëllim të përafrimit dhe studimit sa më të mirë të psikologjisë së njeriut,
- Hulumton format patologjike të sjelljes duke përdorur metoda hulumtuese ose vëzhguese si: anketa, analiza dhe hulumtimi i rasteve, testet e ndryshme specifike psikologjike, për të përjashtuar apo verifikuar bazën organike të sëmundjeve të ndryshme neurologjike,
- Angazhohet në përparimin e metodave diagnostike, terapeutike dhe preventive,
- Kryen dhe punë tjera sipas urdhrat të udhëheqësit, për punën e tij i përgjigjet shefit të repartit dhe ndihmësdrejtorit,
- Ka qëndrim dinjitoz dhe shembullor për të tjerët,
- Jep mendime profesionale në punën e Komisioneve të ndryshme,
- Të kryej detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma e Fakultetit të Psikologjisë;
- Masterin e Psikologjisë Klinike;
- Licençë pune e psikologut klinik;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës, Mjekë specialist të lëmvë përkatëse, dhe Psikolog Klinikë që nuk janë të punësuar në Institucionet Publike Shëndetësore gjegjësisht në Institucionet publike. (Mjekë dhe Psikologë Klinikë).

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohe më këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së

3

Dr. Basri Sejdiu



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
 ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSTIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton për anulimin e konkursit të datës 12.07.2018, për pozitën Zyrtar Ligjor në QRTK Gjilan, Referenca 35/2018, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të konkursit nga kandidatët aplikues, të nevojshme, për kryerjen e procedurës së rregullt të rekrutimit.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, na osnovu procedure zaposljavaanja, obavestava o anuliraju konkursa dana 12.07.2018, o poziciju Pravni Zvaničnik RCKB Gnjilane, Preporuka 35/2018, zbog neispunjenja potrebnih kriterijuma konkursa, od strane kandidata, koji su aplicirali, za završanje redovne procedure za regrutaciju.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Klinički Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Kadrovska Sluzba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/1.-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 6, tačka 1.1 i član 13 tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Sluzbe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 12 i član 13 tačka 1. Statuta Kliničkog Univerzitetski Centr Kosova, Odluke Upravnog Odbora Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK) i Elektronski Zahtev dana 24.07.2018, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

KONKURS

Institucije: Univerzitetski Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova. (UBKSK)
Univerzitetski Klinički Centar Kosova (UKCK)

Nr	Traženo:	Klinika - Sluzba:	Potreb.br.
1	Lekari spec. Pedijatrije u Intenzivno	Pedijatrije	2
2	Lekari spec. Anesteziologije	Anesteziologije I.N.	1
3	Lekar spec. Kardiologije	K.S. Emergency	2
4	Lekar spec. Oftalmologije	Oftalmologije	2
5	Lekar spec. Otorinolaringologije	Otorinolaringologijisë	2
6	Lekar spec. Gjinekologije	AGK	1
7	Klinički Psiholog	UKCK	3

Koeficijent zarade: (8.40) Za lekara specialista,
Koeficijent zarade: (7.20) Za Klinički Psihologa,
Radna Vreme: Puno radno vreme,
Ugovor: P
Izveštaj: Šefu Odeljenja za klinike i sluzbe u UKCK.
Referentni br. UKCK - 29/2018-07/13

I. Osnovna svrha posla – za specialista:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Ključne odgovornosti lekara specijalista:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada.
- obezbedi visok standard nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi.
- Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno.
- Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju.
- Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta.
- Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi.
- Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete,
- Vršiti nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja.
- Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.
- Vršiti konkretne zadatke kada je to potrebno u vezi sa profesijom stručnjaka koji je blisko.
- Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog rada individualnih i kolektivnih na radnom mestu,
- Angažuje osoblje koje radi u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- Obezbediti i razviti programe stručnog osposobljavanja,
- Vršiti redovnu kontrolu (inspekciju objekata, opreme i inventara na radnom mestu).
- Proverite da li je okruženje je čist i bezbedan za sve,
- Upravlja potrošnog materijala i druge opreme,
- Obezbeduje efikasnog sistema komunikacije za sve unutar institucije,
- Analizira i realizuje profesionalne protokole pacijenta,
- Učestvovanje u stručnim naučnim istraživanjima,
- Preuzima mere za povećanje menadžerskih kvalitete i jedinicu kolektivne na odeljenje (Jedinice)
- Izvršiti dodatne zadatke na osnovu njihove profesionalne kvalifikacije i upravljanje, itd
- Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu zasniva na profesionalnom nivou tamo,
- Davanje stručne savjete u tumačenju o lečenju pacijenata i postavljanje dan tretmana,
- Odredi redosled i plan kliničko-laboratorijskih egzaminacija,
- Da bi se rad u klinici ambulantno i ispituje njihovu readmisiju.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti na osnovu specifičnosti institucije

Sposobnost / iskustvo i druge osobine potrebno:

- * Diploma Medicinskog fakulteta;
- * Licenca specijalista odgovarajuće kategorije specialista;
- * Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- * Da ima dokazali veštine i efikasne komunikacije u pismeno i usmeno, imaju znanje službenih jezika u upotrebi;
- * Poznavanje rada sa kompjuterom je od suštinskog značaja i znanje engleskog jezika je povoljno;

- * Licna karta fotokopija ili privremeni boravak i
- * Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Opis rada Kliničkog Psihologa

- * Da koriste različite i savremene metode u cilju približavanja i proučavanja najbolje ljudske psihologije,
- * Istražuje patološke oblike ponašanja ili posmatranja istraživanje koristeći metode kao što su ankete, analize i istraživanja slučajeva, različitih specifičnih psiholoških testova da isključi ili proverimo organsku osnovu raznih neuroloških oboljenja,
- * Uključiti u unapređenje dijagnostičkih, terapijskih i preventivnih metoda,
- * Performanse i drugi rad po naređenju lidera, jer je njegov rad odgovorio šefu odeljenja i pomoćniku direktora,
- * Postoji dostojanstveni i primjeren stav prema drugima,
- * Daje stručna mišljenja o radu različitih odbora,
- * Izvršavati druge dužnosti koje zahtijeva nadzornik za obavljanje poslova u ustanovi u kojoj je zaposlen.

Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

- Diploma Fakulteta za Psihologiju;
- Master kliničke psihologije;
- Licencu kliničkog psihologa;
- Prioritet će dobiti kandidati koji imaju posebnu obuku, kao i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- Imaju dokazanu i efikasnu pismenost i usmene vještine, imaju znanja o službenim jezicima u upotrebi;
- Poznavanje kompjuterskog rada je neophodno, a znanje engleskog jezika je prioritet;
- Fotokopija ili privremena lična karta boravka, i
- Izvod iz matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učešća u zapošljavanju: pravo da se prijave imaju svi građani Republike Kosova, odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje - lekari specijalisti različiti poljima, i Klinički psihologi koji nisu zaposleni u institucijama za javno zdravlje, odnosno javnim institucijama. (Doktori i klinički psihologa).

Uslovi radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: **15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.**

Podnošenje konkursa: Aplikacija se uzimaju i dostavlja - Sektor kadrovski UKCK. U Aplikaciji treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruži aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: **“Haki Stërmilli”** - Zoishtë,
Komuna: Rahovec
Data: **31.07.2018**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/094 - ESIP/SDG/094-CS/1.3	Organizimi i nxënësve ne aktivite jashtëkurrikulare

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **“Haki Stërmilli”**- Zoishtë, Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përkrahimi i shërbimeve të nevojshme:

- Vizitë një ditore me karakter mësimorë nëpër Kosovë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:


- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkolles **“Haki Stërmilli”**-Zoishtë, Rahovec më së largu deri më **08.08.2018**.


4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ilir Kryeziu Diart Morina
Telefoni: +38344280546 +37745884673
E-maili: ilir_kryeziu81@hotmail.com morinadiart120@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01/111/01-0056811-2/18 dt. 31.07.2018
Mitrovicë

Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 22.4 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 4.2 të Statutit të Komunës, Komuna e Mitrovicës së Jugut nxjerr këtë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Institucioni :	Komuna e Mitrovicës së Jugut
Drejtoria:	Inspeksionit
Titulli i vendit të punës:	Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit – INS/140
Kategoria funksionale/Grada:	Profesional – Grada 8 (koeficienti aktual 6)
Numri i referencës:	JP00033934

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me drejtorin harton planin e punës së inspeksionit në fushën e mbrojtjes së ambientit;
- Kujdeset për inspeksionin e nivelit të ndotjes së ajrit, ujit dhe dheut, inspeksionin e mbeturinave e materieve të rrezikshme që shkaktohen nga veprimtaritë industriale, urbane dhe rurale;
- Kryen inspeksionin e aktiviteteve që shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient dhe identifikon palën përgjegjëse, e cila ka shkakuar çrregullime, si dhe inspeksionin e punës së gurthyesve;
- Harton procesverbalet me rastin e inspeksionit, propozon marrjen e masave adekuatë ligjore dhe lëshon fletëparaqitje për shkelje të dispozitivave me të cilat bëhet kundërvajtje;
- Monitoron shërbimet publike komunale, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, kanalizimit, ujit dhe shërbimeve tjera publike për parandalimin e ndotjes së ambientit;
- Merr pjesë në planifikimin lokal të mbrojtjes së mjedisit, masave për mbrojtjen e natyrës, masat tjera mbrojtëse;
- Përgatit dhe lëshon fletëparaqitje për shkelje të dispozitivave me të cilat bëhet kundërvajtje, dhe përpilimin e procesverbaleve me rastin e inspeksionit dhe propozimin e marrjes së masave;
- Kryen dhe detyra tjera në fushën profesionale në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollorë dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.
Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare në fushën e ambientit, mjedisit ose juridik.


- Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:** Minimum 3 (tre) vite përvojë pune profesionale; Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën përkatëse; Njohuri të ligjeve dhe rregullores të aplikueshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit; Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit; Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale; Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Kohëzgjatja e emërimit: Nën punë i karrierës.
Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.
Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës dhe ti bashkëngjiten këto dokumente: diploma mbi kualifikimin, kopja e letërnjoftimit; ekstrakti i lindjes; dëshmi mbi përvojën e punës; dhe certifikata që dëshmojnë njohuri nga fusha përkatëse. Dokumentet duhet të jenë në njërin prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028/531125.


"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët do të njoftohen përmes telefonit dhe e-mail.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01/111/01-0056808-2/18 dt. 31.07.2018
Mitrovicë

Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 22.4 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 4.2 të Statutit të Komunës, Komuna e Mitrovicës së Jugut nxjerr këtë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Institucioni :	Komuna e Mitrovicës së Jugut
Drejtoria:	Inspeksionit
Titulli i vendit të punës:	Inspektor i Komunikacionit – INS/110
Kategoria funksionale/Grada:	Profesional – Grada 8 (koeficienti aktual 6)
Numri i referencës:	JP00033942

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvilloj dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve në fushën komunikacionit;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat e komunikacionit, brenda afateve kohore të caktuara;
- Harton procesverbalet me rastin e inspeksionit dhe propozon marrjen e masave adekuatë ligjore në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi;
- Përgatit dhe lëshon fletëparaqitje për shkelje të dispozitivave me të cilat bëhet kundërvajtje, dhe përpilimin e procesverbaleve me rastin e inspeksionit dhe propozimin e marrjes së masave;
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësive organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen dhe detyra tjera në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollorë dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.
Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare në fushën e komunikacionit.


- Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:** Minimum 3 (tre) vite përvojë pune profesionale; Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën përkatëse; Njohuri të ligjeve dhe rregullores të aplikueshme në fushën e komunikacionit; Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit; Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale; Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Kohëzgjatja e emërimit: Nën punë i karrierës.
